FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 204

Tiranë – E premte, 20 nëntor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11825, datë 12.11.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	14437
Dekret i Presidentit nr. 11839, datë 18.11.2020	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	14437
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 61, datë 4.11.2020	Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kushteve kur zbatohen masat e ndërhyrjes së hershme dhe për kushtet dhe mënyrën e kryerjes së administrimit të përkohshëm".....	14437
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 62, datë 4.11.2020	Për miratimin e rregullores "Për krijimin, licencimin, mbikëqyrjen, funksionimin dhe përfundimin e veprimtarisë së bankës urë".....	14444
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 63, datë 4.11.2020	Për miratimin e rregullores "Për raportin e levës financiare të bankave".....	14450
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 64, datë 4.11.2020	Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS".....	14481

DEKRET
Nr. 11825, datë 12.11.2020

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, këtyre personave:
1. Roland Alain Marius Mercier
2. Kenan Mustafa Adnan Bayrakci
3. Ahmed Shourbagy Rashad Hassan Arafa
4. Önder Murat Hasan Delialioğlu
5. Xhevide Halit Mustafa (Hasani)
6. Lirim Shefki Mustafa
7. Kezban Esat Durmaz (Göktuğ)
8. Valmire Behxhet margjeka (Dedinca)
9. Mrike Gjon Lleshaj
10. Fatima Mohamad Albuni
11. Cenk Ahmet Özmutlu
12. Atdhe Sejd Gjocaj
13. Mariana Marin Enache
14. Sinan Nurettin Düğencioğlu
15. Nijazidin Enver Juniku
16. Nabila Miftah Mabruk Frag
17. Asam Abdul Sattar
18. Silvio Giovanni Orsini
19. Xhevahire Hazir Dema (Demiri)
20. Selman Osmon (Osman) Jashanica
21. Enver Imer Rukolli
22. Arijeta Ismail Parashumti (Mumxhija)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11839, datë 18.11.2020

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Renalda Rasim Lumeshi
2. Raimonda Hasan Lumeshi (Lushakaj)
3. Çuman (Cuman) Kastriot Shahaj
4. Andi Sadedin Schmidko (Bilaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 61, datë 4.11.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE KUR ZBATOHEN MASAT E NDËRHYRJES SË HERSHME DHE PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E KRYERJES SË ADMINISTRIMIT TË PËRKOHSHËM"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; nenit 17, pika 3, dhe nenit 19, pika 13, të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për përcaktimin e kushteve kur zbatohen masat e ndërhyrjes së hershme dhe të kushteve dhe mënyrës së kryerjes së administrimit të përkohshëm", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 30 qershor 2021.

ZËVENDËSKRYETAR
Luljeta Minxhozi

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve kur zbatohen masat e ndërhyrjes së hershme dhe i kushteve dhe mënyrës së administrimit të përkohshëm.

Neni 2
Baza juridike

1. Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) nenit 17, pika 3, dhe nenit 19, pika 13, të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë" (më poshtë ligji "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme").

Neni 3
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4, të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe në nenin 4 dhe kreun IV të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme".

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Masa të ndërhyrjes së hershme" janë masat e ndërhyrjes së hershme të përcaktuara në nenin 17, të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme".

b) "Procesi i Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës" (PRVM) është pjesë integrale e procesit mbikëqyrës që ushtrohet nga Banka e Shqipërisë, siç përcaktohet në kërkesat e udhëzuesit nr. 26, datë 3.5.2017, "Mbi procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit".

c) "Vlerësimi i përgjithshëm i bankës" është vlerësimi i bazuar mbi pikët e caktuara për secilin nga elementet e PRVM-së, dhe merr në konsideratë të gjithë informacionin në dispozicion për bankën.

d) "Vlerësimi i elementeve të rrezikut" është vlerësimi, i cili merr në konsideratë vlerësimin e elementeve sasiore dhe atyre cilësore të rrezikut.

e) "Pikëzimi i përgjithshëm i PRVM-së" është treguesi numerik i rrezikut të përgjithshëm ndaj qëndrueshmërisë së bankës, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të saj (bankës).

3. Në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë është autoriteti mbikëqyrës, sipas kuptimit të pikës 2 të nenit 6, të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme".

KREU II
PËRCAKTIMI I KUSHTEVE PËR MASAT E NDËRHYRJES SË HERSHME

Neni 4
Kushtet për zbatimin e masave të ndërhyrjes së hershme

1. Banka e Shqipërisë vlerëson nëse do të zbatojë masat e ndërhyrjes së hershme, kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) pikëzimi i përgjithshëm i gjendjes së bankës, bazuar në PRVM, është në nivelin 6; ose

b) pikëzimi i përgjithshëm i gjendjes së bankës, bazuar në PRVM, është në nivelin 5 dhe pikëzimi i të paktën njërit prej elementeve të

mëposhtme të PRVM-së është i vlerësuar në nivelin 6:

i. drejtimi i brendshëm dhe sistemet e kontrollit;

ii. rreziku i kredisë;

iii. rreziku i likuiditetit;

iv. rreziku strategjik dhe modeli i biznesit;

v. vlerësimi i kapitalit bazuar në PRVM;

vi. vlerësimi i likuiditetit bazuar në PRVM;

c) kur evidentohen ndryshime materiale ose anomali në treguesit e PRVM-së, sipas përcaktimit në nenin 5 të kësaj rregulloreje; ose

d) kur ndodhin ngjarje të rëndësishme, sipas përcaktimit në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë, në rastet kur plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni:

a) kryen analizën e nevojshme dhe dokumenton shkaqet që mund të çojnë në marrjen e masave për ndërhyrje të hershme; dhe

b) vlerëson urgjencën e situatës dhe rëndësinë e problematikës në situatën e përgjithshme të bankës, me qëllim që të vendosë për llojin e masave për ndërhyrje të hershme që duhet të ndërmarrë.

3. Banka e Shqipërisë dokumenton të gjithë informacionin që lidhet me evidentimin e kushteve/situatave të ngjashme, të rezultateve të analizave të mëtejshme dhe të vendimmarrjes për zbatimin e masave të ndërhyrjes së hershme, si dhe arsyet përkatëse në rastin e mosmarrjes së masave të ndërhyrjes së hershme.

4. Banka e Shqipërisë, në rastet kur vendos të zbatojë një masë të ndërhyrjes së hershme, merr parasysh masat e përcaktuara në planin e rimëkëmbjes që banka ka marrë ose ka vendosur të marrë në të ardhmen e afërt.

5. Banka e Shqipërisë, në rastet kur e vlerëson bankën me një rezultat të përgjithshëm të PRVM-së "6", merr parasysh sigurimin e të gjithë informacionit të nevojshëm për vlerësimin e aktiveve dhe të detyrimeve të bankës, edhe në funksion të zbatimit të shkronjës "dh", pika 1, të nenit 17, të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtë-zakonshme".

6. Banka e Shqipërisë, në rastet kur vendos zbatimin e masave të ndërhyrjes së hershme bazuar në rezultatet (pikët) e mësipërme të PRVM-së dhe për zgjedhjen e masës më të përshtatshme, trajton dobësitë e veçanta të identifikuara dhe të theksuara në përshkrimin e vlerësimit të përgjithshëm të PRVM-së ose të vlerësimit të një elementi të veçantë të tij.

7. Banka e Shqipërisë, nëse banka plotëson kushtet për ndërhyrje të hershme, vendos të zbatojë masat e ndërhyrjes së hershme, menjëherë pas përcaktimit të shkakut dhe ndikimit të përgjithshëm, pa përditësuar vlerësimin e elementit përkatës të PRVM-së. Vlerësimi i elementit përkatës të PRVM-së dhe vlerësimi i përgjithshëm i PRVM-së duhet të përditësohet më pas pa vonesa të panevojshme.

Neni 5

Monitorimi i treguesve nën PRVM

1. Procesi i vlerësimit të rreziqeve kërkon që Banka e Shqipërisë të kryejë monitorim të rregullt të treguesve të PRVM-së për të gjitha bankat.

2. Banka e Shqipërisë e konsideron evidentimin e ndryshimeve materiale dhe anomalive në tregues, përfshirë shkeljet e kufijve, si shtysë për një analizë të mëtejshme dhe, aty ku është e mundur, rishikon vlerësimin lidhur me elementet e PRVM-së, në bazë të të dhënave të reja. Banka e Shqipërisë, në veçanti:

a) përcakton shkakun dhe kryen vlerësimin e materialitetit të ndikimit të mundshëm (potencial) në një bankë dhe, ku është me rëndësi, angazhohet në një dialog efektiv me bankën;

b) dokumenton shkakun/qet dhe rezultatet e vlerësimit; dhe

c) aty ku është me rëndësi, rishikon vlerësimin e rrezikut dhe pikëzimin e PRVM-së, në saje të çdo gjetjeje materiale të re.

3. Banka e Shqipërisë, në rastet kur gjendja financiare e bankës dhe perspektiva e rrezikut për elemente të caktuara të PRVM-së përkeqësohen ndjeshëm dhe ndikojnë në një nga kushtet e bazuara në kombinimin e pikëzimit të përgjithshëm të PRVM-së dhe pikët për elementet individuale të PRVM-së, merr vendimin nëse duhet të zbatojë masat e ndërhyrjes së hershme.

4. Banka e Shqipërisë, pa rënë në kundërshtim me pikën 3 të këtij neni, mund të përdorë drejtpërsëdrejti, në rrethana të caktuara, ndryshimet materiale ose anomalitë në tregues,

për të vendosur zbatimin e masave të ndërhyrjes së hershme.

Neni 6
Ngjarje të rëndësishme

1. Ngjarje të caktuara mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në gjendjen financiare të bankës, duke e vendosur atë në një situatë ku kushtet për ndërhyrjen e hershme janë përmbushur relativisht shpejt, duke ndryshuar ose duke mos ndryshuar pikëzimi i përgjithshëm i gjendjes së bankës, bazuar në PRVM, sipas përcaktimeve të nenit 4 të kësaj rregulloreje.

2. Shembuj të ngjarjeve të rëndësishme, por jo vetëm, që mund ta vënë bankën përpara një situate ku janë përmbushur kushtet për ndërhyrjen e hershme, mund të përfshijnë:

a) ngjarje madhore të rrezikut operacional (për shembull mashtrim, fatkeqësi natyrore, probleme të teknologjisë së informacionit, gjoba të konsiderueshme nga autoritetet publike);

b) rënie e qenësishme e vlerës së detyrimeve të pranuara dhe e kapitalit rregullator të mbajtur nga banka, për përmbushjen e kërkesave minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara;

c) sinjalizime për nevojën e rishikimit të cilësisë së aktiveve dhe/ose kryerjen në mënyrë të pavarur të vlerësimit të portofolave/aktiveve specifike, si për shembull:

i. rezultatet e ekzaminimit në vend, të raporteve të kredimarrësve nga regjistri i kredisë, raportimet periodike etj.;

ii. opinioni i audituesit të jashtëm mbi pasqyrat financiare të bankës evidenton/thekson pasiguri materiale;

iii. ngjarje me efekte të mundshme financiare ose mbi treguesit e tjerë të bankës, të cilat nuk janë pasqyruar ende në pasqyrat financiare të bankës;

iv. rregullime të vazhdueshme dhe materiale të pasqyrave financiare të bankës, për shkak të gabimeve në vlerësimin e aktiveve/detyrimeve dhe ndryshimeve të shpeshta në trajtimet/ supozimet kontabël;

d) flukse dalëse të konsiderueshme të fondeve, duke përfshirë depozitat me pakicë të konsumatorëve, të shkaktuara, për shembull, nga rënia e reputacionit të bankës;

e) largimet e paparashikuara në përbërjen e këshillit drejtues ose stafit drejtues kryesor, të cilët nuk janë zëvendësuar;

f) një ose më shumë anëtarë të këshillit drejtues shkelin kërkesat ligjore dhe rregullative për administratorët e bankave, për t'u emëruar anëtarë apo për të mbetur anëtarë të këshillit drejtues;

g) rënie të rëndësishme të vlerësimit të bankës nga një ose më shumë agjenci të vlerësimit të jashtëm, të cilat mund të çojnë në tërheqje të konsiderueshme të fondeve, paaftësi për të rinovuar kontratat e financimit ose aktivizim të kushteve të caktuara kontraktuale që lidhen me vlerësimin e bankës nga këto agjenci.

3. Banka e Shqipërisë, pasi vihet në dijeni për një ngjarje të rëndësishme, identifikon shkakun e saj, vlerëson ndikimin e saj të mundshëm (potencial) mbi bankën dhe, ku është e mundur, angazhohet në një dialog efektiv me bankën, si dhe dokumenton vlerësimin e saj.

4. Në rrethana të veçanta, ngjarjet e rëndësishme mund të përdoren si kusht për marrjen e vendimit mbi zbatimin e masave të ndërhyrjes së hershme. Banka e Shqipërisë, në veçanti, në varësi të madhësisë së ngjarjes së rëndësishme dhe të materialitetit të ndikimit prudencial të mundshëm mbi bankën dhe, nëse banka i plotëson kushtet për ndërhyrjen e hershme, mund të vendosë të zbatojë masat për ndërhyrjen e hershme, menjëherë pas përcaktimit të shkakut dhe ndikimit të përgjithshëm, pa përditësuar vlerësimin e elementit përkatës të PRVM-së. Vlerësimi i elementit përkatës të PRVM-së dhe vlerësimi i përgjithshëm i PRVM-së duhet të përditësohet më pas pa vonesa të panevojshme.

5. Në rast se Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme fillon procesin e konsultimit me Departamentin e Mbikëqyrjes për të përcaktuar nëse një bankë është në kushtet e paaftësisë paguese, Departamenti i Mbikëqyrjes e konsideron këtë si ngjarje të rëndësishme për të vlerësuar zbatimin e masave të ndërhyrjes së hershme, për të ruajtur ose rivendosur rentabilitetin dhe për të parandaluar paaftësinë paguese të bankës.

KREU III
ADMINISTRIMI I PËRKOHSHËM

Neni 7
Kushtet për zbatimin e administrimit të përkohshëm

1. Banka e Shqipërisë, në rastet kur banka nuk zbaton masat e ndërhyrjes së hershme të kërkuara prej saj (Bankës së Shqipërisë) për përkeqësim të konsiderueshëm të gjendjes financiare të bankës ose për shkelje me pasoja të rënda të legjislacionit në fuqi për bankat dhe të rregullave të tjera apo statutit të bankës dhe në rast se këto masa nuk janë të mjaftueshme për të korrigjuar gjendjen financiare të saj (bankës), mund të urdhërojë bankën të shkarkojë nga detyra një ose disa prej administratorëve të bankës, anëtarë të këshillit drejtues dhe/ose të drejtorisë dhe të emërojë administratorë të rinj.

2. Banka e Shqipërisë, në rastet kur banka nuk zbaton urdhrin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ose kur konsideron se zëvendësimi i administratorëve nga banka është i pamjaftueshëm në funksion të përmirësimit të situatës financiare të bankës, ka të drejtë të emërojë një ose më shumë administratorë të përkohshëm për bankën.

3. Administratori i përkohshëm, i emëruar sipas këtij neni, duhet të plotësojë të gjitha kushtet kualifikuese dhe skualifikuese për administratorët e bankës, të përcaktuara në ligjin "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme", ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 8
Vendimi për emërimin e administratorit të përkohshëm

1. Vendimi, për emërimin e administratorit të përkohshëm dhe për detyrat që do t'i ngarkohen, merret nga organi i bankës së Shqipërisë, i parashikuar në rregulloren "Për përcaktimin e nivelit të ushtrimit të kompetencave në Bankën e Shqipërisë për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka".

2. Vendimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të përmbajë minimalisht:

a) emërimin e administratorit të përkohshëm;

b) objektivat dhe detyrat e administratorit të përkohshëm;

c) nëse administratori i përkohshëm do të zëvendësojë këshillin drejtues dhe/ose drejtuesit ekzekutivë të bankës, apo do të administrojë bankën së bashku me këto organe, si dhe detyrat dhe kompetencat e tij;

d) ndarjen e kompetencave mes administratorit të përkohshëm dhe këshillit drejtues dhe/ose drejtuesit ekzekutiv të bankës, dhe akteve ligjore në lidhje me të cilat këto organe duhet të marrin mendimin dhe/ose pëlqimin (miratimin) e administratorit të përkohshëm – nëse banka administrohet bashkërisht nga administratori i përkohshëm dhe këto organe;

e) afatet dhe mënyrën e raportimit në Bankën e Shqipërisë;

f) shpërblimin e administratorit të përkohshëm;

g) mandatin e administratorit të përkohshëm.

3. Vendimi për emërimin e administratorit të përkohshëm në një bankë ose shkarkimi apo zëvendësimi i tij, në rastet kur autorizohet të përfaqësojë bankën me palët e treta, regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), brenda 5 (pesë) ditësh nga data e marrjes së vendimit. Vendimi publikohet, gjithashtu, në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës se Shqipërisë.

Neni 9
Kompetencat dhe detyrat e administratorit të përkohshëm

1. Administratori i përkohshëm ushtron kompetencat dhe përmbush detyrat e përcaktuara në ligjin "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme" dhe në vendimin për zbatimin e administrimit të përkohshëm dhe është përgjegjës për moszbatimin e detyrave tij në Bankën e Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë përcakton kompetencat dhe detyrat e administratorit të përkohshëm, në përputhje me kompetencat e këshillit drejtues dhe/ose drejtuesit ekzekutiv, si dhe me të drejtat, detyrat dhe kompetencat e anëtarëve të këtyre organeve të përcaktuara me ligj, statutet e bankës dhe ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

3. Kompetencat e administratorit të përkohshëm përcaktohen në mënyrë të tillë që të ndahen qartë përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e tij me organet e tjera të bankës, të cilat mund të përfshijnë pjesëmarrjen në mbledhjet e këshillit

drejtues dhe drejtuesve të bankës, thirrjen e mbledhjeve të këtyre organeve dhe të komiteteve të tjera të bankës, duke propozuar agjendën e takimeve të tilla, duke propozuar miratimin e vendimeve të duhura, duke kërkuar raporte të përshtatshme nga këshilli drejtues, si dhe nga komitete të tjera dhe njësitë përkatëse të bankës etj.

4. Objektivat dhe detyrat e administrimit të përkohshëm mund të lidhen me përcaktimin e gjendjes financiare të vërtetë të bankës, të administrimit të të gjithë ose të një pjese të veprimtarisë së bankës, me qëllim ruajtjen ose rivendosjen e pozicionit të duhur financiar të bankës dhe/ose aktivitetin e saj të sigurt dhe të shëndoshë, mbikëqyrjen mbi veprimtaritë e përcaktuara me vendim të Bankës së Shqipërisë, mbikëqyrjen mbi kryerjen e aktiviteteve të këshillit drejtues ose të drejtuesve ekzekutivë dhe të komiteteve të tjera të bankës.

5. Në rastet kur vendimi për emërimin e administratorit të përkohshëm përcakton se administratori duhet të zëvendësojë këshillin drejtues dhe/ose drejtuesit ekzekutivë të bankës, funksionet e anëtarëve të këtyre organeve do të përfundojnë që nga data e hyrjes në fuqi të vendimit për zbatimin e administrimit të përkohshëm dhe funksionet e tyre do të transferohen tek administratori i përkohshëm.

6. Banka i jep administratorit të përkohshëm akses në të gjitha njësitë organizative dhe godinat e bankës, mundëson komunikimin e tij me menaxherët/administratorët dhe punonjësit e bankës dhe i vë në dispozicion të dhënat mbi veprimtarinë e bankës dhe dokumente të tjera të nevojshme për të përmbushur objektivat dhe detyrat e përmendura më lart.

7. Nëse Autoriteti Mbikëqyrës e emëron administratorin e përkohshëm për të bashkëpunuar me këshillin drejtues të bankës, atëherë këshilli drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë të bankës marrin nga administratori i përkohshëm pëlqimin paraprak dhe/ose një opinion mbi akte të caktuara dhe veprime ligjore të ndërmarra nga këto organe, të cilat përcaktohen në vendimin për zbatimin e administrimit të përkohshëm. Aktet apo veprimet ligjore mund të jenë, por pa u kufizuar, për miratimin e kredisë dhe dhënien e shërbimeve të tjera financiare ndaj personave që lidhen me bankën, huamarrjen e bankës, investimin e bankës në aktive ose subjekte të tjera ligjore, shitjen e aktiveve të bankës, futjen e produkteve të reja, përcaktimin e shpërblimit të anëtarëve të organeve drejtuese të bankës dhe administrimin, duke përfshirë bonuset dhe shpërblimet që u paguhen këtyre personave ose punonjësve të tjerë të bankës.

8. Administratori i përkohshëm, në çdo rast para mbledhjes së asamblesë së bankës dhe caktimit të agjendës së mbledhjes së asamblesë, merr pëlqimin paraprak nga Banka e Shqipërisë, e cila në vendimin për zbatimin e administrimit të përkohshëm mund të përcaktojë që një pëlqim i tillë duhet të merret, gjithashtu, përpara ndërmarrjes së veprimeve të caktuara juridike.

Neni 10

Raportimi i administratorit të përkohshëm

1. Në rast se nuk përcaktohet ndryshe në vendimin e emërimit të administratorit të përkohshëm, ky i fundit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit, paraqet në Bankën e Shqipërisë një raport mbi veprimtarinë dhe gjendjen financiare të bankës, që përmban një vlerësim të gjendjes financiare dhe perspektivave të bankës për përmirësimin e veprimtarive të saj.

2. Nëse në vendimin për zbatimin e administrimit të përkohshëm përcaktohet se administratori i përkohshëm do të menaxhojë/ administrojë bankën së bashku me këshillin drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë të bankës, raporti do t'u dorëzohet, gjithashtu, këtyre organeve që mund të paraqesin kundërshtime ndaj raportit dhe t'ia paraqesin ato administratorit të përkohshëm dhe Bankës së Shqipërisë, brenda pesë ditëve nga data e pranimit të raportit.

3. Administratori i përkohshëm i paraqet Bankës së Shqipërisë mendimin e tij për kundërshtimet e përmendura më sipër, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së tyre.

4. Administratori i përkohshëm, së bashku me raportin, paraqet në Bankën e Shqipërisë një plan veprimi për përmbushjen e objektivave dhe detyrave përgjatë gjithë periudhës së mandatit të tij.

5. Administratori i përkohshëm i paraqet Bankës së Shqipërisë, minimalisht mbi baza tremujore edhe në çdo rast që kërkohet nga Banka e Shqipërisë, një raport mbi veprimet e ndërmarra për të përmbushur objektivat dhe detyrat, shkallën në të cilën janë përmbushur këto objektiva dhe

detyra, si dhe aktivitetet dhe afatet e planifikuara për zbatimin e tyre në periudhën në vazhdim.

6. Administratori i përkohshëm njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo rrethanë që mund të çojë në paaftësinë e bankës për të zbatuar masat e vëna dhe përkeqësimin e gjendjes financiare të saj, si dhe për shpërndarjen e planifikuar të fitimit të bankës ndaj aksionarëve, anëtarëve të organeve drejtuese dhe punonjësve, nëse vlerëson se një shpërndarja e tillë mund të çojë në shkelje të kërkesave ligjore dhe rregullative në fuqi.

7. Banka e Shqipërisë, bazuar në raportet dhe informacionet e përcaktuara më sipër dhe në të dhënat e tjera në dispozicion të saj, mund të vendosë ndonjë nga masat mbikëqyrëse të përcaktuara në ligj "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe/ose të vendosë bankën në administrimin e posaçëm, nëse vlerëson se mund të kontribuojë në arritjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Neni 11

Shpërblimi i administratorit të përkohshëm

1. Banka e Shqipërisë përcakton shpërblimin e administratorit të përkohshëm, duke pasur parasysh në veçanti:

a) fushën e zbatimit të detyrave, kompetencat dhe detyrat e administratorit të përkohshëm, të përcaktuar në vendimin për zbatimin e administrimit të përkohshëm;

b) pagën mesatare mujore të anëtarëve të këshillit drejtues dhe drejtuesve ekzekutivë për tre muajt para miratimit të vendimit për zbatimin e administrimit të përkohshëm;

c) shumën e aktiveve të parashikuara që do të administrojë gjatë mandatit të tij administratori i përkohshëm;

d) gjendjen financiare të bankës; dhe

e) të dhëna të tjera të rëndësishme për përcaktimin e këtij shpërblimi.

2. Shpërblimi për administratorin e përkohshëm paguhet nga banka, e cila është vendosur në administrim të përkohshëm.

Neni 12

Mandati i administratorit të përkohshëm

1. Administratori i përkohshëm emërohet për një mandat jo më shumë se një vit, i cili mund të zgjatet vetëm me vendimin e Bankës së Shqipërisë dhe nëse vazhdojnë të plotësohen kushtet për administrimin e përkohshëm.

2. Administratori i përkohshëm, në rast shtyrjeje të mandatit, duhet të informojë aksionarët e bankës për arsyet e kësaj shtyrjeje.

3. Banka e Shqipërisë, gjatë mandatit të administratorit të përkohshëm, mund të nxjerrë në çdo kohë një vendim për ta shkarkuar atë dhe mund të ndryshojë, gjithashtu, kompetencat dhe detyrat e administratorit të përkohshëm, të përcaktuar në vendimin për zbatimin e administrimit të përkohshëm.

4. Banka e Shqipërisë, kur vlerëson se administratori i përkohshëm nuk respekton afatet e raportimit dhe nuk përmbush detyrat dhe objektivat e vendosur nga Banka e Shqipërisë në vendimin e emërimit, vendos ndërprerjen e parakohshme të mandatit të administratorit të përkohshëm.

Neni 13

Përfundimi i administrimit të përkohshëm

1. Banka e Shqipërisë përfundon administrimin e përkohshëm:

a) me përfundimin e afatit të përcaktuar në vendimin për emërimin e administratorit të përkohshëm dhe/ose vendimin për zgjatjen e mandatit të administratorit të përkohshëm;

b) para përfundimit të afatit të përcaktuar, nëse Banka e Shqipërisë vlerëson se janë përmbushur objektivat dhe detyrat, ose gjendja financiare e bankës është përmirësuar aq sa administrimi i përkohshëm nuk është më i nevojshëm;

c) me zbatimin e administrimit të posaçëm;

d) me vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme; dhe

e) me kalimin në likuidim.

2. Banka e Shqipërisë, në rastin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, nxjerr një vendim për përfundimin e administrimit të përkohshëm, të cilin ia paraqet QKB-së, me qëllim që të regjistrojë përfundimin e administrimit të përkohshëm.

ZËVENDËSKTYETAR I KËSHILLIT
MBIKËQYRËS
Luljeta Minxhozi

VENDIM
Nr. 62, datë 4.11.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KRIJIMIN, LICENCIMIN, MBIKËQYRJEN, FUNKSIONIMIN DHE PËRFUNDIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS URË"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të nenit 28, të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për krijimin, licencimin, mbikëqyrjen, funksionimin dhe përfundimin e veprimtarisë së bankës urë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 27, datë 16.5.2012, "Për miratimin e rregullores 'Për krijimin, licencimin dhe funksionimin e bankës urë'".
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Luljeta Minxhozi

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve të krijimit, licencimit, mbikëqyrjes, funksionimit dhe përfundimit të veprimtarisë së bankës urë, si instrument i ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12 shkronja "a", dhe nenit 43 shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar (ligji "Për Bankën e Shqipërisë");

b) nenit 28, të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë" (ligji "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme").

Neni 3
Subjektet

Subjekt i kësaj rregulloreje është banka urë.

Neni 4
Qëllimi i krijimit të bankës urë

Banka urë krijohet me qëllim që të sigurojë vazhdimësinë e funksioneve kritike të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Neni 5
Përkufizime

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat dhe përkufizimet e përdorur në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (ligji "Për Bankat"), në ligjin "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme" dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

KREU II
KRIJIMI DHE LICENCIMI I BANKËS URË

Neni 6
Krijimi i bankës urë

1. Banka urë është person juridik, e organizuar në formën e një shoqërie aksionare, e cila është tërësisht ose pjesërisht në pronësi të një ose më shumë autoriteteve publike (Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ministrive të linjës, Komisioni i Ndihmës Shtetërore, autoritete të tjera publike sipas legjislacionit në fuqi), si dhe kontrollohet nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

2. Banka e Shqipërisë i paraqet propozimin Ministrisë së Financave, kur e vlerëson të nevojshëm përdorimin e fondeve publike, me qëllim krijimin dhe financimin e kapitalit të bankës urë, si instrument i ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

3. Në vendimin e krijimit të bankës urë mund të vendosen kërkesa më të lehtësuara për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankës urë, në krahasim me kërkesat e përcaktuara për bankat e tjera, në fillimet e ushtrimit të veprimtarisë së saj, duke përcaktuar periudhën gjatë së cilës do të zbatohen këto kërkesa më të lehtësuara, por jo më shumë se 6 muaj.

4. Kërkesat më të lehtësuara sipas pikës 3 të këtij neni, konsistojnë në kërkesa më të lehtësuara për kapitalin fillestar minimal të kërkuar, dokumentacionin për miratimin e administratorëve, si dhe lidhur me zbatimin e treguesve mbikëqyrës të parashikuar në ligjin "Për bankat" dhe në kuadrin rregullator për bankat në fuqi, sipas rastit.

5. Pavarësisht kërkesave të parashikuara në nenet nenin 8 të kësaj rregulloreje, banka urë mund të licencohet edhe kur nuk plotësohen të gjitha kushtet për krijimin e bankës urë, të parashikuara në këtë rregullore, nëse Banka e Shqipërisë vendos se është e domosdoshme për realizimin e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Neni 7
Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit

1. Vendimi për krijimin e bankës urë, si dhe statuti i saj depozitohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2. Pas regjistrimit në regjistrin tregtar, sipas legjislacionit për Qendrën Kombëtare të Biznesit, banka urë pajiset me ekstraktin e regjistrit tregtar.

Neni 8
Licencimi i bankës urë

1. Banka e Shqipërisë është autoriteti për licencimin e bankës urë.

2. Kërkesa për licencimin e bankës urë paraqitet pranë Bankës së Shqipërisë nga aksionarët e propozuar të bankës urë, dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) statuti i miratuar i bankës urë;

b) ekstrakti i regjistrit tregtar për bankën urë, i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

c) emri i propozuar i bankës urë;

d) adresa e selisë dhe e degëve të bankës urë;

e) strategjia dhe profili i rrezikut të bankës urë;

f) plani i biznesit për periudhën që do të ushtrojë veprimtaritë banka urë;

g) parashikimi në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës (tregues të kujdesit, raporte etj., sipas sistemit të raportimit të unifikuar të bankave) gjatë periudhës që do të ushtrojë veprimtaritë banka urë;

h) aktet e brendshme rregullative (rregullore, udhëzime të brendshme etj.) të bankës urë;

i) lista e plotë me emrat e administratorëve të emëruar të bankës urë, që përfaqësojnë bankën urë në marrëdhënie me të tretët.

3. Statuti i bankës urë përmban minimalisht:

a) emrin dhe adresën e aksionarit/ëve themelues;

b) emrin dhe adresën e selisë së bankës urë;

c) objektin e veprimtarisë;

d) të drejtat dhe detyrimet e aksionarit/ëve themelues;

e) shumën e kapitalit fillestar minimal, sipas përcaktimit në ligjin për bankat;

f) numrin total dhe vlerën nominale të aksioneve, përfshirë përshkrimin e të drejtave të votës;

g) mënyrën e kompensimit për shpenzimet e themelimit;

h) organet e administrimit të bankës urë;

i) kompetencat dhe mënyrën e operimit të asamblesë së aksionarëve të bankës urë;

j) mënyrën e zgjedhjes, numrin e anëtarëve dhe kompetencat e këshillit drejtues të bankës urë;

k) mënyrën e zgjedhjes, numrin e anëtarëve dhe kompetencat e drejtorisë së bankës urë;

l) përcaktimin e mënyrës së shpërblimit dhe të pagesës së anëtarëve të këshillit drejtues, pagat dhe përfitimet e tjera të anëtarëve të drejtorisë së bankës urë dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre;

m) organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;

n) auditorin ligjor;

o) afatin e operimit të bankës urë, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 2 vjet nga data më e fundit e kryerjes së transferimit të aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve.

4. Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noteruar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse të shteteve të huaja, ai legalizohet nga autoritetet përgjegjëse.

Neni 9
Karakteristikat e licencës

1. Licenca e bankës urë është licencë e kufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.

2. Licenca ka si pjesë përbërëse të saj aneksin e veprimtarive bankare dhe financiare, sipas nenit 54 të ligjit "Për bankat", të cilat do të ushtrohen nga banka urë.

3. Licenca e bankës urë është e të njëjtit format si licenca që lëshon Banka e Shqipërisë për bankat dhe degët e bankave të huaja.

4. Licenca dhe aneksi i licencës të bankës urë nënshkruhen nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

5. Përbri emrit të bankës urë duhet të pasqyrohet edhe termi "bankë urë".

Neni 10
Afati i dhënies së licencës të bankës urë dhe publikimi

1. Banka e Shqipërisë licencon bankën urë jo më vonë se 5 ditë pune pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2. Vendimi për krijimin e bankës urë dhe licenca e saj publikohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

3. Banka e Shqipërisë mban një regjistër të veçantë për bankat urë dhe e publikon në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

Neni 11
Transferimi i aktiveve dhe i detyrimeve

1. Banka e Shqipërisë zbaton procedurën e transferimit të aktiveve, të drejtave dhe të detyrimeve te banka urë, sipas vendimit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

2. Banka e Shqipërisë kryen transferimin bazuar në pikën 3, të nenit 28, të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme", me kusht që vlera e përgjithshme e detyrimeve të transferuara në bankën urë të mos e tejkalojë vlerën totale të të drejtave dhe aktiveve të transferuara nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme apo të siguruara nga burime të tjera.

3. Transferimi i së drejtës së pronësisë mbi aksionet ose instrumentet e tjera të pronësisë, i aktiveve dhe i detyrimeve, nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme te banka urë, kryhet sipas vendimit referuar pikës 1 të këtij neni, dhe mund të jetë transferim tërësor ose i pjesshëm.

4. Banka e Shqipërisë mund të transferojë më shumë se një herë aktivet dhe detyrimet nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme drejt bankës urë dhe anasjelltas.

5. Banka e Shqipërisë, bazuar në pikën 1 të këtij neni, përcakton rast pas rasti listën e aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve që i transferohen bankës urë.

6. Depozitat që i transferohen bankës urë përbëhen të paktën nga depozitat e siguruara, sipas parashikimeve të legjislacionit mbi sigurimin e depozitave. Banka urë është pjesë e

skemës së sigurimit të depozitave pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

7. Në bankën urë nuk mund të transferohen nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme:

a) depozitat e bllokuara që dyshohen për pastrim parash;

b) depozitat nga palët e lidhura;

c) detyrimet e varura me palët e lidhura.

8. Vlerësimi i aktiveve dhe i detyrimeve, që transferohen nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme te banka urë kryhet në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë nr. 44, datë 5.6.2019, "Për vlerësimin për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme".

Neni 12
Veprimtaritë e bankës urë

1. Banka urë ushtron çdo të drejtë që është ushtruar nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme në lidhje me aktivet, të drejtat ose detyrimet e transferuara, si dhe veprimtaritë dhe shërbimet ndihmëse, siç përcaktohet në vendimin e Bankës së Shqipërisë për krijimin e saj, në përputhje me përcaktimet e ligjit "Për bankat", të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme", të kuadrit rregullativ të Bankës së Shqipërisë, si dhe në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Banka urë kryen veprimtari kredidhënëse të kufizuar dhe me rrezik të ulët.

3. Banka urë, për qëllime të vazhdimësisë së aktivitetit, bën rishikime dhe miraton rregullat operacionale dhe të administrimit të veprimtarisë së saj, në lidhje me depozitat, kreditë, si dhe personelin e informacionin që zotërohej më parë nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

KREU III
STRATEGJIA, PARIMET, ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I BANKËS URË

Neni 13
Strategjia dhe profili i rrezikut të bankës urë

1. Banka urë harton dhe zbaton strategjinë e administrimit të rrezikut ndaj të cilit ekspozohet gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj, referuar shkronjës "e", pika 2, të nenit 8 të kësaj rregulloreje.

2. Strategjia dhe profili i rrezikut përmban një përshkrim të rreziqeve më të rëndësishme ndaj të cilave ekspozohet banka urë, parimet mbi të cilat sigurohet administrimi dhe ndërmarrja e këtyre rreziqeve dhe/ose politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut.

3. Drejtuesit/administratorët e bankës urë diskutojnë periodikisht me Bankën e Shqipërisë profilin e rrezikut dhe zbatimin e strategjisë së administrimit të rrezikut, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Banka urë, në rast të ndryshimit të fakteve dhe të rrethanave mbi të cilat është hartuar strategjia e administrimit të rrezikut, mund të ndryshojë profilin e rrezikut dhe strategjinë e administrimit të rrezikut, duke njoftuar paraprakisht Bankën e Shqipërisë për këto ndryshime.

5. Banka e Shqipërisë jep miratimin për ndryshimet e propozuara, sipas pikës 4 të këtij neni.

Neni 14
Përmbajtja e strategjisë, profilit të rrezikut dhe plan-biznesit

1. Strategjia dhe profili i rrezikut, i referuar në pikën 1 të nenit 13, duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

a) procedurat për administrimin e rrezikut;

b) parashikimet për administrimin e rrezikut të likuiditetit;

c) parashikimet për ushtrimin e funksioneve të kontrollit të brendshëm;

d) parashikimet për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e veprimtarisë terroriste;

e) parashikimet për nënshkrimin e marrëveshjeve me të tretët për ushtrimin e funksioneve dhe të përgjegjësive për administrimin dhe drejtimin e bankës urë.

2. Plani i biznesit, referuar shkronjës "f", pika 2, të nenit 8 të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë të paktën sa vijon:

a) informacionin për vendndodhjen e bankës urë, përfshirë edhe degët e saj;

b) strukturën organizative, numrin e punonjësve të bankës urë, përfshirë linjat e raportimit;

c) veprimtaritë bankare dhe financiare që do të kryejë banka urë;

d) personat përgjegjës për kryerjen e segmenteve të veçanta të planit;

e) punonjësit dhe mënyrën e zbatimit të politikave/rregulloreve të kontrollit të brendshëm;

f) parashikimet financiare;

g) marrëveshjet me të tretët për ushtrimin e funksioneve dhe të përgjegjësive për administrimin dhe drejtimin e bankës urë.

3. Parashikimet financiare, referuar pikës 2 të këtij neni, duhet të përmbajnë të paktën sa vijon:

a) pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;

b) pasqyrën e bilancit;

c) raportet/treguesit e kapitalit dhe të likuiditetit;

d) përshkrimin e hollësishëm të supozimeve të përdorura;

e) pasqyrat financiare të jenë të shoqëruara me shënimet për zërat e tyre.

Neni 15
Organet e administrimit të bankës urë

Organet e administrimit të bankës urë përcaktohen në ligjin për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, ndërsa në raste të veçanta, Banka e Shqipërisë mund të vendosë për struktura më të thjeshta. Organet e administrimit të bankës urë përcaktohen në vendimin për krijimin dhe në statutin e saj.

Neni 16
Parimet e administrimit të bankës urë

1. Administrimi dhe drejtimi i bankës urë synon ruajtjen e madhësisë dhe jo shtrirjen dhe zgjerimin e rrjetit të saj.

2. Administrimi dhe drejtimi i bankës urë synon ruajtjen dhe rritjen e vlerës së aktiveve të bankës dhe të fitimit të saj.

Neni 17
Administratorët e bankës urë

1. Banka e Shqipërisë emëron administratorët e bankës urë, të cilët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të përmbushin kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë dhe në aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për administratorët e bankës ose të degës së bankës së huaj;

b) të kenë përvojë pune, të paktën 7-vjeçare si drejtues, ekzekutivë në bankë, në institucion tjetër financiar ose në një shoqëri ekspertësh kontabël të autorizuar;

c) të mos jenë dënuar nga gjykata për vepra penale;

d) të mos jenë subjekt i hetimeve për vepra penale;

e) të mos jenë në pamundësi për të ushtruar detyrat ndaj bankës, bazuar në një vendim gjykate;

f) të mos kenë konflikt interesi me bankën urë, sipas legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

2. Për vlerësimin e kritereve, sipas pikës 1 të këtij neni, administratori i propozuar i bankës urë paraqet dokumentacionin, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë dhe në aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për administratorët e bankës ose të degës së bankës së huaj.

3. Bazuar në pikën 11, të nenit 28, të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme", Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund t'i shkarkojë administratorët e bankës urë në çdo kohë.

KREU IV
RAPORTIMET DHE MBIKËQYRJA E BANKËS URË

Neni 18
Raportimet

1. Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv dhe/ose administratorët e bankës urë mbajnë kontakte të vazhdueshme me Bankën e Shqipërisë.

2. Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv dhe/ose administratorët e bankës urë raportojnë çdo 2 muaj te Banka e Shqipërisë, në lidhje me ecurinë e gjendjes financiare të bankës urë, si dhe të masave dhe projekteve për shitjen e bankës urë.

Neni 19
Mbikëqyrja e bankës urë

1. Banka urë respekton kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi, në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare të përcaktuara në vendimin e krijimit të saj dhe/ose sipas ndryshimeve të mëvonshme.

2. Banka e Shqipërisë mbikëqyr bankën urë, në përputhje me kërkesat e ligjit "Për bankat", të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme" dhe të akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.

3. Banka e Shqipërisë mund të marrë ndaj bankës urë masat mbikëqyrëse që gjykon të nevojshme, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për bankat", të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme" dhe të kuadrit rregullativ mbikëqyrës të nxjerrë në bazë dhe për zbatim të tyre.

4. Banka urë raporton pranë Bankës së Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar.

5. Me kërkesë të Bankës së Shqipërisë, banka urë mund të raportojë sipas sistemit raportues të unifikuar me frekuenca më të shkurtra se ato të parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi.

KREU V
SHITJA, PËRFUNDIMI DHE REVOKIMI I LICENCËS SË BANKËS URË

Neni 20
Transferimi i kapitalit ose i aktiveve dhe i detyrimeve të bankës urë

1. Banka urë harton një strategji shitjeje, e cila paraqitet për mendim në Bankën e Shqipërisë dhe duhet të marrë parasysh kryesisht faktorët e mëposhtëm:

a) përbërjen e aktiveve dhe të detyrimeve të bankës urë;

b) kushtet ekonomike dhe konkurruese të bankës në tregun përkatës;

c) eksperiencat e mëparshme në tregtimin e aktiveve dhe detyrimeve të një shoqërie (bankë, subjekt financiar jobankë etj.);

d) çdo informacion tjetër të rëndësishëm;

e) si do të tregtohet banka urë (pjesërisht apo e gjitha etj.);

f) cilat lloje të aktiveve të bankës urë duhet t'u ofrohen blerësve të ardhshëm;

g) çmimin e shitjes së aktiveve dhe ku do të bazohet përcaktimi i çmimit të shitjes së aktiveve etj.).

3. Administratorët e bankës urë, pas përfundimit të hartimit të strategjisë dhe të strukturës së shitjes së kapitalit, të aktiveve dhe të detyrimeve të bankës urë, vendosin në dispozicion të bankave blerëse informacionin e mëposhtëm:

a) vendndodhjen gjeografike të bankës urë;

b) mjedisin konkurrues;

c) kushtet e përgjithshme financiare të bankës urë;

d) totalin e aktiveve;

e) nivelin e kapitalit; dhe

f) vlerësimin e bankës urë nga Banka e Shqipërisë.

3. Administratorët e bankës urë, bazuar në listën e blerësve potencialë dhe pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë, mund të vendosin kontakte dhe/ose të kryejnë takime me blerësit potencialë për t'i informuar ata mbi të dhënat, strukturën etj., për sa lidhet me shitjen e bankës urë.

4. Bankat, të cilat do të konsiderohen nga administratorët e bankës urë si blerës potencialë, nënshkruajnë një marrëveshje konfidencialiteti mbi negociatat e mundshme për tregtimin e aktiveve dhe detyrimeve të bankës urë.

5. Në rast se vlera e detyrimeve të bankës urë që do të transferohen është më e madhe se vlera e aktiveve, diferenca ndërmjet këtyre të dyjave është pjesë e çmimit të shitjes që merr përsipër blerësi.

6. Kontrata e shitjes së kapitalit, aktiveve dhe detyrimeve të bankës urë te një bankë tjetër, duhet të miratohet paraprakisht nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Neni 21
Përfundimi i bankës urë

1. Banka e Shqipërisë vendos përfundimin e bankës urë kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) banka urë bashkohet me një bankë tjetër;

b) banka urë nuk plotëson më kërkesat për të cilat është krijuar dhe kushtet e vendosura në vendimin e krijimit sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje;

c) të gjitha ose pjesa kryesore e aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve të bankës urë i janë shitur një pale të tretë;

d) përfundon afati i përcaktuar në vendimin për krijimin e saj.

2. Banka e Shqipërisë merr vendimin për përfundimin e bankës urë.

3. Banka e Shqipërisë siguron zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi kur kërkohet shitja e bankës urë ose shitja e kapitalit, e aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve, këto do të tregtohen në mënyrë të hapur dhe transparente dhe se shitja nuk i paraqet ato materialisht ndryshe ose favorizon padrejtësisht ose diskriminon blerësit potencialë.

4. Nëse nuk ndodh asnjë nga rastet e parashikuara në pikën 1, germat "a", "b", "c" të këtij neni, Banka e Shqipërisë do të përfundojë operacionet e bankës urë sa më shpejt dhe, në çdo rast, dy vjet pas datës në të cilën është bërë transferimi i fundit nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme tek banka urë.

5. Banka e Shqipërisë mund të zgjasë periudhën e përmendur në pikën 4 të këtij neni për një ose më shumë periudha shtesë njëvjeçare, kur një zgjatje e tillë:

a) mbështet rezultatet e përmendura në pikën 1, germat "a", "b", "c" të këtij neni; ose

b) është e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e funksioneve kritike bankare ose financiare.

6. Çdo vendim i Bankës së Shqipërisë për zgjatjen e afatit të përmendur në pikën 5 të këtij neni duhet të jetë i arsyetuar dhe duhet të përmbajë një vlerësim të detajuar të situatës, duke përfshirë kushtet dhe parashikimet e tregut që justifikon zgjatjen e afatit.

Neni 22
Revokimi i licencës së bankës urë

1. Banka e Shqipërisë, pas përfundimit të bankës urë, siç përcaktohet në nenin 21 të kësaj rregulloreje, revokon licencën e saj.

2. Me revokimin e licencës së bankës urë, aktivet dhe detyrimet e patransferuara ose të pashitura vendosen në likuidim nga Banka e Shqipërisë.

3. Likuidimi i aktiveve dhe i detyrimeve të patransferuara ose të pashitura të bankës urë kryhet në përputhje me kriteret, kushtet dhe procedurat e përcaktuara në dispozitat e ligjit "Për bankat", të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme" dhe në aktet rregullative të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre nga Banka e Shqipërisë.

ZËVENDËSKTYETAR I KËSHILLIT
MBIKËQYRËS
Luljeta Minxhozi

VENDIM
Nr. 63, datë 4.11.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR RAPORTIN E LEVËS FINANCIARE TË BANKAVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja "a", dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë', të ndryshuar; të neneve 57 dhe 59, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për raportin e levës financiare të bankave", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Rregullorja "Për raportin e levës financiare të bankave", hyn në fuqi në datën 1 janar 2022.

3. Bankat, deri në hyrjen në fuqi të rregullores "Për raportin e levës financiare të bankave", marrin masat dhe krijojnë kushtet e nevojshme për zbatimin e kërkesave të rregullores. Bankat

raportojnë çdo 6 muaj në Bankën e Shqipërisë, në lidhje me ecurinë e marrjes së masave.

4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

5. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Luljeta Minxhozi

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:

a) kritereve dhe i rregullave për llogaritjen e raportit të levës financiare të bankave; dhe

b) nivelit minimal të raportit të levës financiare.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, të cilat, për thjeshtësi, këtu e më poshtë në këtë rregullore, do të quhen "banka".

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe

b) neneve 57 dhe 59, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, i cili, këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji "për bankat".

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin "Për bankat", si dhe në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" (e cila, për thjeshtësi, në këtë rregullore do të quhet "rregullorja e mjaftueshmërisë së kapitalit"), në rregulloren "Për kapitalin rregullator të bankës" (e cila, për thjeshtësi, në këtë rregullore do të quhet "rregullorja e kapitalit rregullator") dhe në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave" (e cila, për thjeshtësi, në këtë rregullore do të quhet "rregullorja e ekspozimeve të mëdha").

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "blerje ose shitje e rregullt *(regular-way)*" është një blerje ose shitje e një titulli (aktivi financiar), bazuar në kontrata, kushtet e të cilave kërkojnë dorëzimin e titullit (aktivit) brenda periudhës së përcaktuar përgjithësisht në rregullat ose marrëveshjet e tregut përkatës ku titulli (aktivi) shitet ose blihet;

b) "marrëveshje e grumbullimit të *cash*-it *(cash pooling arrangement)*" është një marrëveshje që u referohet produkteve të thesarit ku banka kombinon tepricat kreditore dhe/ose debitore të disa llogarive individuale të klientëve pjesëmarrës, në një tepricë të vetme llogarie, për qëllime të administrimit të *cash*-it dhe/ose të likuiditetit;

c) "derivativ i shitur i kredisë" është çdo instrument financiar (si *credit default swaps*, total *return swaps*, opsionet etj.), përmes të cilit banka ofron/siguron mbrojtje ndaj rrezikut të kredisë, sipas kushteve të specifikuara në kontratë;

d) "transaksionet e financimit nëpërmjet titujve" janë transaksione në formën e marrëveshjeve të riblerjes, marrëveshjeve të anasjella të riblerjes, marrëveshjeve të huadhënies dhe huamarrjes së titujve dhe transaksioneve të huadhënies me marzhe, ku vlera e transaksioneve

varet nga vlerësimet e tregut dhe transaksionet janë shpesh subjekt i marrëveshjeve me marzhe;

e) "kusht material" është çdo karakteristikë e derivativit të kredisë që është e rëndësishme për vlerësimin e tij, përfshirë nivelin e varësisë, opsionalitetin, ngjarjet e kredisë, subjektin ose grupin e subjekteve referencë bazë, dhe detyrimin ose grupin e detyrimeve referencë bazë, me përjashtim të vlerës nominale *(notional)* dhe maturimit të mbetur të derivativit të kredisë;

f) "subjekt referencë" është subjekti që emeton detyrimin referencë, i cili është titulli bazë i një derivativi kredie. Subjekti referencë mund të jetë një shoqëri tregtare, qeveri ose çdo subjekt juridik që emeton borxh të çdo lloji. Nëse ndodh një ngjarje kredie dhe subjekti referencë nuk është në gjendje të plotësojë kushtet e kredisë, blerësi i derivativit të kredisë merr pagesa nga shitësi i derivativit.

g) "strukturë me shumë nivele klientësh" është marrëveshja e klerimit në mënyrë indirekte, sipas së cilës shërbimet e klerimit i ofrohen bankës nga një institucion i cili nuk është anëtar klerimi, por është në vetvete një klient i një anëtari klerimi ose i një klienti të nivelit më të lartë;

h) "klient i nivelit më të lartë" është institucioni/subjekti që ofron shërbime të klerimit për një klient të nivelit më të ulët;

i) "klient i nivelit më të ulët" është institucioni/subjekti që i akseson shërbimet e një kundërpartie qendrore, nëpërmjet një klienti të nivelit më të lartë.

KREU II
LEVA FINANCIARE

Neni 5
Raporti i levës financiare

1. Bankat llogarisin raportin e levës financiare në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

2. Bankat sigurojnë në çdo kohë një raport të levës financiare, prej të paktën 5.75%, në baza individuale dhe të konsoliduara.

3. Bankat respektojnë në çdo kohë raportin e levës financiare të parashikuar në pikën 2 të këtij neni. Në rast se raporti i levës financiare bie nën kufirin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, banka raporton menjëherë në Bankën e Shqipërisë, duke përcaktuar edhe masat e nevojshme dhe kohën për rivendosjen e këtij raporti brenda kufirit të përcaktuar.

Neni 6
Llogaritja e raportit të levës financiare

1. Raporti i levës financiare llogaritet si raport i kapitalit të nivelit të parë të bankës, me ekspozimin total të bankës në datën e raportimit, dhe shprehet në përqindje.

$$\text{Raporti i levës financiare (\%)} = \frac{\text{Kapitali i nivelit të parë}}{\text{Ekspozimi total i bankës}}$$

2. Për qëllime të llogaritjes së raportit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, bankat llogarisin kapitalin e nivelit të parë, në përputhje me metodologjinë e parashikuar në rregulloren e kapitalit rregullator.

3. Për qëllime të llogaritjes së raportit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, bankat llogarisin vlerën e ekspozimit total, si shumë të zërave/elementeve të mëposhtëm/e:

a) aktivet në bilanc, të cilët përllogariten në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje;

b) ekspozimet që krijohen nga kontratat e derivativëve të parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, të cilat përllogariten në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje;

c) ekspozimet që krijohen nga derivativët e kredisë, të cilët përllogariten në përputhje me nenin 9 të kësaj rregulloreje;

d) ekspozimet që krijohen nga transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, të cilat përllogariten në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje;

e) ekspozimet jashtë bilancit, duke përjashtuar ekspozimet jashtë bilancit që krijohen nga kontratat dhe transaksionet e parashikuara në shkronjat "b", "c" dhe "d" të kësaj pike, të cilat përllogariten në përputhje me nenin 11 të kësaj rregulloreje;

f) blerjet ose shitjet e rregullta *(regular-way)* në pritje të shlyerjes, të cilat përllogariten në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje.

4. Përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë rregullore, bankat llogarisin ekspozimin total në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) vlera e ekspozimit matet sipas vlerës së tij kontabël dhe shprehet në baza bruto;

b) kolaterali fizik në formën e aktiveve të qëndrueshme ose kolaterali financiar, garancitë ose teknikat e tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë, nuk përdoren për të reduktuar vlerën totale të ekspozimit të bankës;

c) aktivet (të drejtat) nuk netohen me pasivet (detyrimet).

5. Bankat, për të siguruar një trajtim konsistent, zbresin nga vlera e ekspozimit total të parashikuar në këtë nen, çdo zë të zbritshëm nga kapitali i nivelit të parë sipas përcaktimeve në rregulloren e kapitalit rregullator, përveç zërave që lidhen me detyrimet.

6. Banka origjinuese në një titullzim tradicional, mund të përjashtojë ekspozimet e titullzuara nga vlera e ekspozimit total të parashikuar në këtë nen, nëse titullzimi plotëson kërkesat operacionale për njohjen e transferimit të një pjese të konsiderueshme të rrezikut, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat që plotësojnë këto kërkesa, përfshijnë në vlerën e ekspozimit total, çdo ekspozim të titullzuar të mbajtur/të patransferuar prej tyre *(retained)*.

7. Bankat, në rastet e titullzimeve tradicionale, që nuk plotësojnë kërkesat operacionale për njohjen e transferimit të një pjese të konsiderueshme të rrezikut ose të titullzimeve sintetike, përfshijnë vlerën e ekspozimeve të titullzuara në vlerën e ekspozimit total.

8. Banka e Shqipërisë, në situata të veçanta, mund të vendosë që bankat të përjashtojnë rezervat në bankën qendrore nga llogaritja e vlerës së ekspozimit total të parashikuar në këtë nen, për një periudhë jo më të gjatë se një vit. Në këtë rast, bankat respektojnë raportin minimal të modifikuar të levës financiare, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

9. Bankat, në rastin e përjashtimit të rezervave në bankën qendrore nga llogaritja e vlerës së ekspozimit total të parashikuar në pikën 8 të këtij neni, llogaritin dhe raportojnë në Bankën e Shqipërisë, si dhe publikojnë raportin e modifikuar të levës financiare, së bashku me raportin e levës financiare të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje. Mënyra e përllogaritjes së raportit të modifikuar të levës financiare përcaktohet nga Banka e Shqipërisë dhe u komunikohet bankave.

KREU III
LLOGARITJA E VLERËS SË EKSPOZIMEVE

Neni 7
Llogaritja e vlerës së ekspozimit për zërat e aktiveve në bilanc

1. Bankat, për llogaritjen e vlerës së ekspozimit për zërat e aktiveve në bilanc, marrin në konsideratë të gjithë zërat, duke përfshirë edhe kolateralet e marra për derivativët dhe transaksionet e financimit nëpërmjet titujve të regjistruar në bilanc, por përjashtojnë derivativët në bilanc dhe aktivet e transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve, të cilët trajtohen sipas përcaktimeve në nenet 8 deri në 10 të kësaj rregulloreje.

2. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit për zërat e aktiveve në bilanc, duke marrë në konsideratë vlerën e tyre kontabël, pas zbritjes së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve (përfshirë edhe fondet rezervë statistikore), rregullimeve të tjera të vlerës në përputhje me nenin 9 të rregullores së kapitalit rregullator dhe reduktimeve të kapitalit rregullator që lidhen me këta zëra të aktiveve.

3. Në rastet kur bankat, në përputhje me standardet kontabël, njohin aktivet e marra në kujdestari *(fiduciary assets)* si zëra të bilancit, këto aktive nuk përfshihen në ekspozimin total për qëllime të llogaritjes së raportit të levës financiare, me kushtin që të plotësojnë kriteret e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar për mosnjohjen[1] *(derecognition)* dhe, aty ku është e zbatueshme, kriteret[2] për moskonsolidimin *(deconsolidation)*.

4. Bankat, në rastet kur një marrëveshje e grumbullimit të *cash*-it kërkon transferim të paktën në baza ditore në një llogari të vetme, të balancave kreditore dhe/ose debitore të llogarive individuale të klientëve pjesëmarrës në këtë marrëveshje, për qëllime të llogaritjes së vlerës së ekspozimit total, marrin në konsideratë balancën

[1] SNRF 9.
[2] SNRF 10.

e kësaj llogarie të vetme dhe i vendosin vlerën 0 (zero) balancës së llogarive individuale të klientëve pjesëmarrës. Pas transferimit, bankat nuk mbajnë përgjegjësi për balancat e llogarive individuale të klientëve pjesëmarrës në marrëveshje.

5. Bankat, në rastet kur për një marrëveshje të grumbullimit të *cash*-it nuk ndodh transferimi në baza ditore i balancave kreditore dhe/ose debitore të llogarive individuale të klientëve pjesëmarrës në këtë marrëveshje, konsiderojnë se ka ndodhur transferimi në një llogari të vetme dhe kjo balancë/shumë shërben si baza e vlerës së ekspozimit total, me kusht që të përmbushen të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) banka ka të drejtën ligjore për të transferuar, në çdo moment, balancat e llogarive individuale të klientëve pjesëmarrës, në një llogari të vetme dhe pas transferimit, banka nuk mban përgjegjësi për balancat në baza individuale;

b) Banka e Shqipërisë konsideron që shpeshtësia me të cilën transferohen balancat e të gjitha llogarive individuale të klientëve pjesëmarrës në një llogari të vetme është e përshtatshme/e mjaftueshme për qëllime të llogaritjes së vlerës së ekspozimit total;

c) nuk ka mospërputhje të maturitetit midis llogarive individuale të klientëve pjesëmarrës të përfshira në marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it ose të gjitha llogaritë janë njëditore ose pa afat;

d) banka merr ose paguan interes dhe/ose komisione, bazuar në balancën e kombinuar të llogarive individuale të klientëve pjesëmarrës të përfshirë në marrëveshjen e grumbullimit të *cash*-it.

6. Në rast se nuk përmbushen kërkesat e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, banka i pasqyron balancat individuale të llogarive të klientëve pjesëmarrës, në mënyrë të veçuar në vlerën e ekspozimit total.

7. Bankat trajtojnë *cash*-in dhe titujt/aktivet e lidhur me shitjet dhe blerjet e rregullta *(regular way sales and purchases)*, që paraqiten në bilanc deri në datën e shlyerjes, si zëra të aktiveve në bilanc.

8. Bankat që zbatojnë kontabilizimin sipas datës së tregtimit *(trade date accounting)* për blerjet dhe shitjet e rregullta që janë në pritje të shlyerjes, në përputhje me standardet e kontabilitetit, stornojnë *(reverse out)* netimin midis shumës *cash* të arkëtueshme për shitjet e rregullta në pritje të shlyerjes dhe shumës *cash* të pagueshme për blerjet e rregullta në pritje të shlyerjes, të lejueshëm nga standardet kontabël. Bankat, pasi kanë stornuar *(reverse out)* netimin kontabël, mund të netojnë shumën *cash* të arkëtueshme dhe shumën *cash* të pagueshme, për shitjet dhe blerjet e rregullta që shlyhen në bazë të "dorëzimit kundrejt pagesës" *(delivery vs. payment* – DVP).

9. Bankat që zbatojnë kontabilizimin sipas datës së shlyerjes *(settlement date accounting)* për blerjet dhe shitjet e rregullta, që janë në pritje të shlyerjes, në përputhje me standardet e kontabilitetit, përfshijnë në vlerën e ekspozimit total, vlerën e plotë nominale të detyrimeve për t'u paguar në lidhje me blerjet e rregullta.

Bankat netojnë këtë vlerë me vlerën e plotë nominale të llogarive të arkëtueshme, në lidhje me shitjet e rregullta në pritje të shlyerjes, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) blerjet dhe shitjet e rregullta shlyhen mbi bazën e "dorëzimit kundrejt pagesës" (DVP);

b) aktivet financiare të blera dhe të shitura, të lidhura me llogaritë e pagueshme dhe të arkëtueshme, vlerësohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe përfshihen në librin e tregtueshëm të bankës.

Neni 8

Llogaritja e vlerës së ekspozimit për derivativët

1. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit të kontratave të derivativëve të parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të derivativëve të kredisë, përfshirë edhe kontratat dhe derivativët e kredisë jashtë bilancit, sipas metodës *mark-to-market* të parashikuar në nenin 129 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

2. Bankat, në rastet kur ekspozimi i derivativëve është i mbuluar nga një marrëveshje dypalëshe netimi e njohur/e pranuar, zbatojnë trajtimin sipas parashikimeve në pikat 3 deri në 5 të këtij neni.

3. Bankat, për qëllime të llogaritjes së vlerës së ekspozimit total, mund të netojnë transaksionet, që janë subjekt i marrëveshjeve dypalëshe të zëvendësimit dhe i formave të tjera të marrëveshjeve dypalëshe të netimit, të

parashikuara në nenin 134, pika 2, të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, vetëm nëse plotësohen kushtet e parashikuara në nënkreun II, të kreut VI të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

4. Bankat, për qëllime të llogaritjes së vlerës së ekspozimit total, për marrëveshjet që përmbajnë klauzola *walkaway*[3] *(walkaway clauses)*, nuk mund të bëjnë netimin në përputhje me këtë nen.

5. Bankat përllogarisin vlerën e ekspozimit për derivativët e shitur të kredisë, në përputhje me nenin 9 të kësaj rregulloreje.

6. Bankat, për transaksionet derivative që mbulohen nga një kontratë dypalëshe netimi, siç parashikohet në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, zbatojnë mënyrën e llogaritjes së vlerës së ekspozimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, për të gjithë grupin e netimit (kompensimit).

7. Bankat, për transaksionet derivative që nuk mbulohen nga një kontratë dypalëshe netimi siç parashikohet në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, përcaktojnë vlerën e ekspozimit, në mënyrë të veçantë për çdo transaksion.

8. Bankat, për qëllime të llogaritjes së vlerës së ekspozimit total sipas kërkesave të këtij neni, nuk zbresin vlerën e kolateralit/garancisë së marrë nga kundërpartia, nga vlera e ekspozimit të derivativit.

9. Bankat, në rastet kur vlera e kolateralit/garancisë të dhënë kundërpartisë është zbritur nga zërat e aktiveve të bilancit, në përputhje me standardet kontabël, i shtojnë vlerës së ekspozimit vlerën e këtij kolaterali/ garancie të dhënë kundërpartisë.

Neni 9

Llogaritja e vlerës së ekspozimit për derivativët e shitur të kredisë

1. Bankat, përveç llogaritjes së vlerës së derivativëve, siç parashikohet në nenin 8 të kësaj rregulloreje, përfshijnë në llogaritjen e vlerës së ekspozimit të derivativëve të shitur të kredisë, edhe shumën nominale *(notional)* efektive të referuar për këto lloje derivativësh, pas zbritjes së diferencave negative në vlerën e drejtë që janë përfshirë në kapitalin e nivelit të parë, në lidhje me këta derivativë të shitur të kredisë.

2. Bankat llogarisin shumën nominale *(notional)* efektive të derivativëve të shitur të kredisë, duke rregulluar/korrigjuar *(adjust)* shumën nominale *(notional)* të këtyre derivativëve, për të reflektuar ekspozimin e vërtetë të kontratave me përdorim të levës *(leveraged)* ose që pësojnë rritje vlere si rezultat i strukturës së transaksionit *(enhanced)*.

3. Bankat mund të reduktojnë pjesërisht ose plotësisht vlerën e ekspozimit të përllogaritur në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni, me shumën nominale *(notional)* efektive të derivativëve të blerë të kredisë, për të njëjtin emër referencë[4], nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) derivativët e blerë të kredisë janë subjekt i të njëjtave kushte materiale ose i kushteve më konservatore se ato të derivativëve përkatës të shitur të kredisë;

b) maturiteti i mbetur i derivativit të blerë të kredisë është i barabartë ose më i madh se maturiteti i mbetur i derivativit të shitur të kredisë;

c) në rast se shuma nominale *(notional)* efektive e një derivativi të shitur të kredisë është reduktuar me diferencat negative në vlerën e drejtë të përfshirë në kapitalin e nivelit të parë të bankës, shuma nominale *(notional)* efektive e derivativit të blerë të kredisë reduktohet me diferencat pozitive në vlerën e drejtë të përfshirë në kapitalin e nivelit të parë; dhe

d) derivativi i blerë i kredisë nuk është përfshirë në një transaksion që është shlyer nga banka në emër të klientit (ose që është shlyer nga banka në rolin e saj si klient i nivelit më të lartë në një strukturë me shumë nivele klientësh) dhe për të cilin shuma nominale efektive e referuar nga derivativi i shitur i kredisë është përjashtuar nga llogaritja e vlerës së ekspozimit, në përputhje me këtë pikë.

[3] "Klauzolë *walkaway* (*walkaway clause***)**" është një dispozitë që lejon një kundërparti që nuk është në dështim, të bëjë vetëm disa pagesa të kufizuara ose asnjë pagesë, për shlyerjen e detyrimit që ka ndaj një kundërpartie në paaftësi paguese, edhe nëse kjo e fundit është një kreditor neto në kontratën e netimit (kompensimit).

[4] Dy emra referencë do të konsiderohen të njëjtë vetëm nëse i referohen të njëjtit person juridik.

4. Bankat, pa rënë ndesh me shkronjën "a", të pikës 3 të këtij neni, mund të përdorin derivativët e blerë të kredisë në një grup emrash referencë, për të kompensuar derivativët e shitur të kredisë me emra individualë referencë brenda atij grupi, nëse grupi i subjekteve referencë dhe niveli i varësisë në të dyja transaksionet është i njëjtë.

5. Bankat nuk reduktojnë vlerën nominale *(notional)* efektive të derivativit të shitur të kredisë, nëse kanë blerë mbrojtje të kredisë nëpërmjet një total *return swap*, për të cilin pagesat neto të marra regjistrohen si të ardhura neto dhe netimi i përkeqësimit të vlerës së derivativit të shitur të kredisë (nëpërmjet reduktimit në vlerën e drejtë ose shtimit të rezervave) nuk regjistrohet në kapitalin e nivelit të parë.

6. Bankat, në rastin e derivativëve të blerë të kredisë në një grup të detyrimeve referencë, mund të reduktojnë shumën nominale *(notional)* efektive të derivativëve të shitur të kredisë për detyrimet referencë individuale, me shumën nominale *(notional)* efektive të derivativëve të blerë të kredisë, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, vetëm nëse mbrojtja e blerë është ekuivalente me blerjen e mbrojtjes në mënyrë të veçuar, për secilin prej detyrimeve në grupin përkatës.

Neni 10

Llogaritja e vlerës së ekspozimit për transaksionet e financimit nëpërmjet titujve

1. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit për transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, sipas trajtimit të parashikuar në këtë nen.

2. Në rastet kur banka vepron si emetues për transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, vlera e ekspozimit për këto transaksione llogaritet si shumë e elementeve të parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni.

3. Bankat përfshijnë në vlerën e ekspozimit, aktivet e transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve, të njohura sipas standardeve të kontabilitetit, mbi baza bruto, pas rregullimeve të mëposhtme:

a) përjashtohet nga vlera e ekspozimit, vlera e çdo titulli të marrë/të pranuar në transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, kur titulli është njohur si aktiv në bilancin e bankës; dhe

b) në rastin e transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve me të njëjtën kundërparti, llogaritë e pagueshme dhe të arkëtueshme në *cash* llogariten mbi baza neto, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. transaksionet kanë qartësisht të njëjtën datë përfundimtare të shlyerjes (transaksionet që nuk kanë një datë përfundimtare të qartë, por që mund të përfundojnë në çdo kohë nga secila palë në transaksion, nuk konsiderohen si të pranueshme për qëllime të kësaj nënpike),

ii. e drejta për të netuar vlerën që banka i detyrohet kundërpartisë, me vlerën që kundërpartia i detyrohet bankës, është ligjërisht e zbatueshme, si në rrjedhën normale të biznesit, ashtu edhe në rast të dështimit, paaftësisë paguese ose falimentimit të kundërpartisë, dhe

iii. kundërpartitë synojnë të shlyejnë mbi baza neto, të shlyejnë njëkohësisht ose transaksionet janë subjekt i një mekanizmi shlyerjeje që rezulton në ekuivalentin e shlyerjes neto, që nënkupton se flukset e parasë të transaksioneve janë ekuivalente me një shumë të vetme neto në datën e shlyerjes. Për të arritur ekuivalencën, transaksionet shlyhen përmes të njëjtit sistem shlyerjeje, marrëveshjet e shlyerjes mbështeten nga *cash*-i dhe/ose lehtësira kredie brenda ditës që synojnë të sigurojnë që shlyerja e transaksioneve do të ndodhë deri në fund të ditës së punës dhe lidhja me flukset nga kolaterali nuk ndikon në përfundimin e shlyerjes neto të shumave në *cash*.

4. Bankat, për të matur vlerën e ekspozimit për transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, marrin në konsideratë edhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritur në përputhje me sa parashikohet në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.

5. Bankat, për transaksionet me një kundërparti subjekt i një marrëveshje tip netimi (kompensimi), e cila plotëson kushtet e pranueshmërisë të parashikuara në nenin 73 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, llogarisin vlerën e ekspozimit për çdo marrëveshjeje (llogaritje mbi bazë marrëveshjesh), në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$E_i^* = \max \{0, [\Sigma E_i - \Sigma Ci]\}$$

ku:

E_i^* - është vlera e ekspozimit për rrezikun e kredisë së kundërpartisë;

i - është indeksi që identifikon marrëveshjen e netimit;

E_i - është vlera e drejtë e titujve ose e parave *cash* të dhëna kundërpartisë, për të gjitha transaksionet që janë subjekt i marrëveshjes tip të netimit "i";

C_i - është vlera e drejtë e titujve ose e parave *cash* të marra nga kundërpartia, për të gjitha transaksionet që janë subjekt i marrëveshjes tip të netimit "i".

6. Bankat, për transaksionet me një kundërparti, të cilat janë subjekt i një marrëveshje tip netimi (kompensimi), që nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë të parashikuara në nenin 73 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, llogarisin vlerën e ekspozimit për çdo transaksion (llogaritje mbi bazë transaksionesh), në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$E_i^* = \max \{0, [E_i - C_i]\}$$

ku,

E_i^*- është vlera e ekspozimit për rrezikun e kredisë së kundërpartisë;

i - është indeksi që identifikon transaksionin;

E_i - është vlera e drejtë e titujve ose e parave *cash* të dhëna kundërpartisë për transaksionin "i";

C_i - është vlera e drejtë e titujve ose e parave *cash* të marra nga kundërpartia për transaksionin "i".

7. Banka mund ta vendosë në zero vlerën e ekspozimit E_i^* të parashikuar në pikën 6 të këtij neni, nëse:

a) E_i janë paratë *cash* të dhëna një kundërpartie;

b) transaksioni trajtohet si grupi i vet i netimit; dhe

c) *cash*-i i marrë në lidhje me këtë transaksion nuk është i pranueshëm për trajtimin mbi baza neto, të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

Neni 11
Llogaritja e vlerës së ekspozimit për zërat jashtë bilancit

1. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit të zërave jashtë bilancit, duke përjashtuar kontratat derivative të parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, derivativët e kredisë dhe transaksionet e financimit nëpërmjet titujve të parashikuara në nenet 8 deri në 10 të kësaj rregulloreje, në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

2. Bankat, për qëllime të llogaritjes së raportit të levës financiare, llogarisin vlerën e ekspozimit për zërat jashtë bilancit të parashikuar në aneksin 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, duke zbatuar mbi vlerën e ekspozimit të mundshëm përqindjet (faktorët e konvertimit) të mëposhtme:

a) 100% për kategorinë me rrezik të lartë;

b) 50% për kategorinë me rrezik të mesëm;

c) 20% për kategorinë me rrezik të ulët;

d) 10% për kategorinë pa rrezik.

KREU IV
KËRKESA MBIKËQYRËSE

Neni 12
Kërkesa raportuese

1. Bankat raportojnë mbi baza tremujore në Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, raportin e levës financiare, mbi baza individuale dhe të konsoliduara, sipas Sistemit Raportues të Unifikuar dhe formularëve të aneksit 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 13
Masat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në nenet 74 deri 80 dhe në nenin 89 të ligjit për bankat.

Neni 14
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 1 janar 2022.

2. Bankat, deri në hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, raportojnë mbi baza tremujore në Bankën e Shqipërisë raportin e levës financiare mbi baza individuale, sipas formularëve të aneksit 1, duke filluar nga muaji mars 2021.

Neni 15
Dispozitë e fundit

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

ZËVENDËSKRYETARI I KËSHILLIT
MBIKËQYRËS
Luljeta Minxhozi

ANEKSI 1 - RAPORTI I LEVËS FINANCIARE

FORMULARËT E RAPORTIMIT TË LEVËS FINANCIARE				
Numri i formularit	Kodi i formularit	Emri i formularit	Periodiciteti	Linku
1	F 1	Formulari 1 - Llogaritja e raportit të levës financiare	Tremujor	F1
2	F 2	Formulari 2 - Trajtimi alternativ i vlerës së ekspozimit	Tremujor	F2
3	F 3	Formulari 3 - Metoda alternative e paraqitjes së elementëve përbërës të shumës së ekspozimit të total	Tremujor	F3

Shënim: 1. Bankat, për formularët F1 - F3, nuk duhet të plotësojnë fushat me ngjyrë të kuqe.

2. Bankat, për formularët F1 - F3, nuk duhet të plotësojnë fushat me ngjyrë gri, pasi ato përmbajnë formula.

3. Bankat, respektojnë në çdo kohë, raportin e levës financiare të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje dhe raportojnë në Bankën e Shqipërisë të dhënat sipas Formularëve F1-F3, mbi baza individuale dhe të konsoliduara.

Formulari F1 - LLOGARITJA E RAPORTIT TË LEVËS FINANCIARE

Rreshti	Vlera e Ekspozimit	Vlera e ekspozimit në datën e raportimit
0010	Transaksionet e financimit nëpërmjet titujve: Vlera e ekspozimit	
0020	Transaksionet e financimit nëpërmjet titujve: Shtesat për rrezikun e kredisë së kundërpartisë	
0030	Derivativët: kontributi i kostos së zëvendësimit sipas metodës *Mark-to-Market* për rrezikun e kredisë së kundërpartisë	
0040	Derivativët: Kontributi i ekspozimit të mundshëm të ardhshëm sipas metodës *Mark-to-Market* për rrezikun e kredisë së kundërpartisë	
0050	Shuma nominale *(notional)* e derivativëve të shitur të kredisë	
0060	(-) Reduktimi i njohur i derivativëve të blerë të kredisë kundrejt derivativëve të shitur të kredisë	
0070	Zërat jashtë bilancit me (përqindje) faktor konvertimi 10%	
0080	Zërat jashtë bilancit me (përqindje) faktor konvertimi 20%	
0090	Zërat jashtë bilancit me (përqindje) faktor konvertimi 50%	
0100	Zërat jashtë bilancit me (përqindje) faktor konvertimi 100%	
0110	Blerjet dhe shitjet e rregullta në pritje të shlyerjes: Vlera kontabël sipas datës së tregtimit	
0120	Shitjet e rregullta në pritje të shlyerjes: Stornimi *(reverse out)* i netimit kontabël në rastet e kontabilizimit sipas datës së tregtimit	
0130	(-) Shitjet e rregullta në pritje të shlyerjes: netimi në përputhje me nenin 7, pika 8 në rastet e kontabilizimit sipas datës së tregtimit	
0140	Blerjet e rregullta në pritje të shlyerjes: Njohja e plotë e detyrimeve për t'u paguar në rastet e kontabilizimit sipas datës së shlyerjes	
0150	(-) Blerjet e rregullta në pritje të shlyerjes: netimi i detyrimeve për t'u paguar në rastet e kontabilizimit sipas datës së shlyerjes	
0160	Aktive të tjera	
0170	(-) Rregullimet *(adjustments)* e përgjithshme të rrezikut të kredisë për zërat e bilancit	
0180	Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që nuk mund të netohen nga pikëpamja prudenciale: vlera sipas standardeve kontabël	
0190	Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që nuk mund të netohen nga pikëpamja prudenciale: ndikimi i shtesave të vlerës (*grossing-up*) të netimit të aplikuar sipas standardeve kontabël	
0200	Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që mund të netohen nga pikëpamja prudenciale: vlera sipas standardeve kontabël	
0210	Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që mund të netohen nga pikëpamja prudenciale: ndikimi i shtesave të vlerës (*grossing-up*) të netimit të aplikuar sipas standardeve kontabël	
0220	(-) Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që mund të netohen nga pikëpamja prudenciale: Njohja e netimit në përputhje me nenin 7, pika 4	
0230	(-) Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që mund të netohen nga pikëpamja prudenciale: Njohja e netimit në përputhje me nenin 7, pika 5	
0240	Shtesa e vlerës *(gross-up)* për kolateralin e dhënë për derivativët	
0250	(-) Aktivet e marra në kujdestari *(fiduciary assets)*	
0260	(-) Ekspozimet e titullzuara të përjashtuara që përfaqësojnë transferimin e një pjese të konsiderueshme të rrezikut	
0270	(-) Rezervat e përjashtuara në bankën qendrore	
0280	(-) Vlera e aktiveve që zbritet nga kapitali i nivelit të parë	
0290	**Vlera totale e ekspozimit për qëllime të llogaritjes së raportit të levës financiare**	0
Rreshti	**Kapitali**	
0300	**Kapitali i nivelit të parë**	
Rreshti	**Raporti i Levës Financiare**	
0310	**Raporti i levës financiare**	

Formulari F2- TRAJTIMI ALTERNATIV I VLERËS SË EKSPOZIMIT

Rreshti		Vlera kontabël në bilanc	Vlera kontabël duke supozuar që nuk ka netim ose teknika të tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë	Shuma nominale (notional)	Shuma nominale (notional) efektive	Shuma nominale (notional) efektive (i njëjti emër referencë)	Shuma e ekspozimit të levës financiare
		0010	0020	0030	0040	0050	0060
0010	Derivativët	0	0	0			
0020	Derivatët e shitur të kredisë			0			
0030	Derivatët e shitur të kredisë, që janë subjekt i një klauzole të përfundimit (close-out)						
0040	Derivatët e shitur të kredisë, që nuk janë subjekt i një klauzole të përfundimit (close-out)						
0050	Derivatët e blerë të kredisë						
0060	Derivativët financiarë						
0070	Transaksionet e financimit nëpërmjet titujve						
0080	Aktivet e tjera						
0090	Zërat jashtë bilancit						
0100	Kolaterali në *Cash* i marrë nga transaksionet e derivativëve						
0110	Shuma të arkëtueshme për kolateralin në *cash* të postuar në transaksionet e derivativëve						
0120	Titujt e marrë në një transaksion të financimit nëpërmjet titujve që njihen si aktive						
0130	Rezervat në bankën qendrore						
0140	Vlera e rezervave në bankën qendrore e përdorur për llogaritjen e raportit të modifikuar të levës financiare, të përcaktuar në nenin 6 të rregullores						
0150	Vlera e ekspozimit që përdoret për llogaritjen e raportit të modifikuar të levës financiare të përcaktuar në nenin 6 të rregullores						

Formulari F3 - METODA ALTERNATIVE E PARAQITJES SË ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHUMËS SË EKSPOZIMIT TOTAL

Rreshti		Zërat jashtë bilancit, derivativët, transaksionet e financimit nëpërmjet titujve dhe libri i tregtueshëm	Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare	Ekspozimet e ponderuara me rrezikun
			0010	0020
0010	0010	Zërat jashtë bilancit		
0020	0020	prej të cilave: Financimi tregtar		
0050	0030	Derivativët		
0060	0040	Transaksionet e financimit nëpërmjet titujve		
0065	0050	Shumat e ekspozimit që vijnë si rezultat i trajtimit shtesë për derivativët e kredisë		
0070	0060	Aktive të tjera që i përkasin librit të tregtueshëm		
Rreshti		**Ekspozime të tjera që nuk i përkasin librit të tregtueshëm**	**Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde**	**Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde**
			0010	0020
0080	0070	Obligacione të garantuara		
0090	0080	Ekspozimet e trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore	0	0
0100	0090	Qeveritë qendrore dhe bankat qendrore		
0110	0100	Qeveritë rajonale dhe autoritetet lokale, të trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore		
0120	0110	Bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare të trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore		
0130	0120	Njësitë e sektorit publik të trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore		
0140	0130	Ekspozimet ndaj qeverive rajonale, bankave shumëpalëshe të zhvillimit, organizatave ndërkombëtare dhe njësive të sektorit publik që **nuk** trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore	0	0
0150	0140	Qeveritë rajonale dhe autoritet lokale që **nuk** trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore		
0160	0150	Bankat shumëpalëshe të zhvillimit që **nuk** trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore		
0170	0160	Njësitë e sektorit publik që **nuk** trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore		
0180	0170	Institucionet e mbikëqyrura		
0190	0180	Ekspozime të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme		
0200	0190	Prej të cilave: Ekspozime të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale		
0210	0200	Ekspozime me pakicë *(retail)*		
0220	0210	Prej të cilave: Ekspozime me pakicë *(retail)* ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME)		
0230	0220	Ekspozime ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	0	0
0240	0230	Financiare		
0250	0240	Jo-financiare	0	0
0260	0250	Ekspozime ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME)		
0270	0260	Ekspozimet, përveç ekspozimeve ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME)		
0280	0270	Ekspozime me probleme		
0290	0280	Ekspozime të tjera		
0300	0290	Prej të cilave: Ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi		

ANEKSI 2

UDHËZUES SHPJEGUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARËVE TË ANEKSIT 1

RAPORTIMI MBI RAPORTIN E LEVËS FINANCIARE

Përmbajtja:

PJESA I: UDHËZIME TË PËRGJITHSHME
STRUKTURA DHE KONVENCIONE TË TJERA
1.1 STRUKTURA
1.2 KONVENCIONET NUMERIKE
1.3 KONVENCIONET E SHENJAVE
1.4 FORMULAT PËR LLOGARITJEN E RAPORTIT TË LEVËS FINANCIARE

PJESA II: UDHËZIME LIDHUR ME FORMULARËT
I. FORMULARI F1 – LLOGARITJA E RAPORTIT TË LEVËS FINANCIARE
II. FORMULARI F2 – TRAJTIMI ALTERNATIV I VLERËS SË EKSPOZIMIT
III. FORMULARI F3 – METODA ALTERNATIVE E PARAQITJES SË ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHUMËS SË EKSPOZIMIT TOTAL

PJESA I
UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

1. Struktura dhe konvencione të tjera

1.1 Struktura

1. Ky aneks përmban udhëzime për plotësimin e formularëve të aneksit 1 të kësaj rregulloreje.

2. Bankat do të raportojnë sipas tre formularëve të mëposhtëm:

- Formulari F1 – **Llogaritja e raportit të levës financiare**;
- Formulari F2 – **Trajtimi alternativ i vlerës së ekspozimit**;
- Formulari F3 – **Metoda alternative e paraqitjes së elementeve përbërëse të shumës së ekspozimit total**.

3. Për çdo formular paraqiten referencat rregullative, si dhe informacion i mëtejshëm i detajuar, në lidhje me aspektet më të përgjithshme të raportimit.

1.2 Konvencionet numerike

4. Udhëzuesi ndjek konvencionet e klasifikimit të përcaktuara në vijim, kur u referohet kolonave, rreshtave dhe qelizave të formularëve.

5. Në udhëzimet shpjeguese ndiqet rregulli i përgjithshëm i mëposhtëm: {formulari; rreshti; kolona}.

6. Në rast të udhëzimeve shpjeguese brenda njëjtit formular, shënimet nuk do të referojnë formularin, por do të shënohen në këtë formë: {rreshti; kolona}. Në rast të udhëzimeve shpjeguese të formularit F1, shënimet nuk do të referojnë kolona, por vetëm rreshtin dhe shënohen në këtë formë: {Rreshti}.

7. Për qëllime të raportimit mbi raportin e levës financiare, shënimi "nga i cili" i referohet një zëri që është një nënbashkësi e një kategorie të ekspozimit të një niveli më të lartë.

1.3 Konvencionet e shenjave

8. Si rregull i përgjithshëm, të gjitha vlerat raportohen si shifra pozitive, me përjashtim të:

a) zërave, të cilët paraprihen nga një shenjë negative (-) në formular dhe kur nuk pritet të raportohet asnjë vlerë pozitive për atë zë;

b) rreshtit {0300} dhe rreshtit {0310} në formularin F1, të cilët mund të marrin vlera negative në raste ekstreme, në të kundërt marrin vlera pozitive.

1.4 Formulat për llogaritjen e raportit të levës financiare

9. Raporti i levës financiare merr në konsideratë kapitalin e nivelit të parë dhe vlerën totale të ekspozimit, e cila llogaritet sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe i merr vlerat nga formulari F1, përkatësisht për kapitalin e nivelit të parë nga rreshti {0300}, dhe për vlerën totale të ekspozimit nga rreshti {0290}.

10. $\text{Raporti i levës financiare (\%)} = \frac{\text{Kapitali i nivelit të parë}}{\text{Ekspozimi total i bankës}}$

PJESA II
UDHËZIME LIDHUR ME FORMULARËT

I. Formulari F1 – Llogaritja e raportit të levës financiare

1. Ky formular mbledh të dhënat që nevojiten për të llogaritur raportin e levës financiare, siç përcaktohet në këtë rregullore.

2. Bankat raportojnë çdo tremujor formularët e raportimit mbi elementet dhe raportin e levës financiare. Për çdo tremujor, vlera "në datën referencë të raportimit" do të jetë vlera e ditës së fundit kalendarike e muajit të tretë të tremujorit përkatës.

3. Bankat raportojnë zërat në kolonën "Vlera e ekspozimit", me shenjë pozitive, në përputhje me konvencionet e shenjave të parashikuara në seksionin 1.3 të këtij aneksi, përveç rreshtit {0280}, sikur zërat me shenjë negative (për shembull përjashtimet/zbritjet), në përputhje me konvencionet e shenjave në seksionin 1.3 të këtij aneksi, të mos merreshin në konsideratë.

4. Çdo vlerë që rrit kapitalin rregullator apo ekspozimin total, raportohet si shifër pozitive. Në të kundërt, çdo vlerë që zvogëlon kapitalin rregullator apo ekspozimin total, raportohet si një shifër negative. Nëse ekziston një shenjë negative (-) para emërtimit të një zëri në formular, nuk pritet që banka të raportojë një shifër pozitive për atë zë.

5. Nëse një vlerë mund të kualifikohet për t'u zbritur nga disa zëra, kjo vlerë lejohet të zbritet vetëm nga një zë/rresht i formularit, për të shmangur llogaritje të dyfishta.

	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
Rreshti	**Vlera e ekspozimit**
0010	**Transaksionet e financimit nëpërmjet titujve: Vlera e ekspozimit** *Neni 10, pika 3* Në këtë rresht paraqitet vlera e ekspozimit për transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, e cila përllogaritet, sipas përcaktimeve në nenin 10, pika 3, të rregullores. Bankat nuk përfshijnë në këtë rresht shumën *cash* të marrë apo vlerën e çdo titulli të dhënë kundërpartisë, nëpërmjet një transaksioni të tillë, i cili është njohur si aktiv në bilanc (d.m.th. nuk janë plotësuar kriteret kontabël për mosnjohjen (*derecognition*)). Në këtë rast, bankat përfshijnë këto zëra në rreshtin {0160}.
0020	**Transaksionet e financimit nëpërmjet titujve: Shtesat për rrezikun e kredisë së kundërpartisë** *Neni 10, pika 4* Në këtë rresht paraqitet shtesa *(add-on)* për rrezikun e kredisë së kundërpartisë për transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, përfshirë edhe transaksionet jashtë bilancit, të përcaktuara në pikën 5 ose 6 të nenit 10 të rregullores, sipas rastit.
0030	**Derivativët: Kontributi i kostos së zëvendësimit sipas metodës *Mark-to-Market* për rrezikun e kredisë së kundërpartisë** *Neni 8, pika 1* Në këtë rresht paraqitet kostoja aktuale e zëvendësimit të kontratës, e përllogaritur sipas parashikimeve në nenin 129 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Siç përcaktohet në nenin 8, pika 2, të rregullores, bankat mund të netojnë transaksionet që janë subjekt i marrëveshjeve dypalëshe të zëvendësimit dhe formave të tjera të marrëveshjeve dypalëshe të netimit, në përputhje me parashikimet në këtë nen. Bankat përfshijnë të gjithë derivativët e kredisë, jo vetëm ata në librin e tregtueshëm.
0040	**Derivativët: Kontributi i ekspozimit të mundshëm të ardhshëm sipas metodës *Mark-to-Market* për rrezikun e kredisë së kundërpartisë** *Neni 8, pika 1*

	Në këtë rresht paraqitet ekspozimi i mundshëm i ardhshëm i kredisë, i përllogaritur sipas parashikimeve në nenin 129 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.
0050	**Shuma nominale *(notional)* e derivativëve të shitur të kredisë** *Neni 9* Në këtë rresht paraqitet shuma nominale *(notional)* efektive e derivativëve të shitur të kredisë (siç përcaktohet në nenin 9 të rregullores).
0060	**(-) Reduktimi i njohur i derivativëve të blerë të kredisë kundrejt derivativëve të shitur të kredisë** *Neni 9* Në këtë rresht paraqitet shuma nominale *(notional)* efektive e derivativëve të blerë të kredisë (d.m.th., kur banka blen mbrojtje të kredisë nga një kundërparti) për të njëjtët emra referencë, si ato të derivativëve të kredisë të shitur nga banka, kur maturiteti i mbetur i mbrojtjes (derivativit) të blerë është i barabartë ose më i madh se maturiteti i mbetur i mbrojtjes (derivativit) të shitur. Në këtë mënyrë, vlera nuk mund të jetë më e madhe se vlera e regjistruar në rreshtin {0050}, për çdo emër referencë.
0070	**Zërat jashtë bilancit me (përqindje) faktor konvertimi 10%** *Neni 11* Në këtë rresht paraqitet vlera e ekspozimit, siç parashikohet në nenin 11 të kësaj rregulloreje, për zërat jashtë bilancit parrezik, të referuar në aneksin 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, të cilëve u korrespondon një përqindje (faktor konvertimi) 0%, ku vlera e ekspozimit për këto zëra do të jetë 10% e vlerës nominale. Në këtë rresht, bankat nuk përfshijnë kontratat derivative të parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, derivativët e kredisë dhe transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, në përputhje me nenin 11 të rregullores.
0080	**Zërat jashtë bilancit me (përqindje) faktor konvertimi 20%** *Neni 11* Në këtë rresht paraqitet vlera e ekspozimit, siç parashikohet në nenin 11 të kësaj rregulloreje, për zërat jashtë bilancit me rrezik të ulët, të referuar në aneksin 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, të cilëve u korrespondon një përqindje (faktor konvertimi) 20%, ku vlera e ekspozimit për këto zëra do të jetë 20% e vlerës nominale. Në këtë rresht, bankat nuk përfshijnë kontratat derivative të parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, derivativët e kredisë dhe transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, në përputhje me nenin 11 të rregullores.
0090	**Zërat jashtë bilancit me (përqindje) faktor konvertimi 50%** *Neni 11* Në këtë rresht paraqitet vlera e ekspozimit, siç parashikohet në nenin 11 të kësaj rregulloreje, për zërat jashtë bilancit me rrezik të mesëm, të referuar në aneksin 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, të cilëve u korrespondon një përqindje (faktor konvertimi) 50%, ku vlera e ekspozimit për këto zëra do të jetë 50% e vlerës nominale. Në këtë rresht, bankat nuk përfshijnë kontratat derivative të parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, derivativët e kredisë dhe transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, në përputhje me nenin 11 të rregullores.
0100	**Zërat jashtë bilancit me (përqindje) faktor konvertimi 100%**

	Neni 11 Në këtë rresht paraqitet vlera e ekspozimit, siç parashikohet në nenin 11 të kësaj rregulloreje, për zërat jashtë bilancit me rrezik të lartë, të referuar në aneksin 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, të cilëve u korrespondon një përqindje (faktor konvertimi) 100%, ku vlera e ekspozimit për këto zëra do të jetë 100% e vlerës nominale. Në këtë rresht, bankat nuk përfshijnë kontratat derivative të parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, derivativët e kredisë dhe transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, në përputhje me nenin 11 të rregullores.
0110	**Blerjet dhe shitjet e rregullta në pritje të shlyerjes: Vlera kontabël sipas datës së tregtimit *(trade date accounting)*** *Neni 7, pika 7* Në këtë rresht paraqitet shuma e: - vlerës së *cash*-it të lidhur me blerjet e rregullta (*regular way purchases*) që paraqiten në bilanc deri në datën e shlyerjes, si zëra të aktiveve; - *cash*-it të arkëtueshëm të lidhur me shitjet e rregullta (*regular way sales*) që paraqiten në bilanc deri në datën e shlyerjes, si zëra të aktiveve. Kjo shumë llogaritet pas netimit midis shumës *cash* të arkëtueshme për shitjet e rregullta në pritje të shlyerjes dhe shumës *cash* të pagueshme për blerjet e rregullta në pritje të shlyerjes, të lejueshme nga standardet kontabël në fuqi. Bankat që zbatojnë kontabilizimin, sipas datës së tregtimit raportojnë shumën e lartpërmendur në këtë rresht, dhe jo në rreshtin {0160} "Aktive të tjera", ndërsa raportojnë titujt/aktivet e lidhur me blerjet e rregullta në rreshtin {0160}.
0120	**Shitjet e rregullta në pritje të shlyerjes: Stornimi *(reverse out)* i netimit kontabël në rastet e kontabilizimit, sipas datës së tregtimit *(trade date accounting)*** *Neni 7, pika 8* Në këtë rresht paraqitet shuma e netuar midis *cash*-it të arkëtueshëm për shitjet e rregullta në pritje të shlyerjes dhe *cash*-it të pagueshëm për blerjet e rregullta në pritje të shlyerjes, të lejueshme nga standardet kontabël në fuqi.
0130	**(-) Shitjet e rregullta në pritje të shlyerjes: netimi në përputhje me nenin 7, pika 8, në rastet e kontabilizimit sipas datës së tregtimit (*trade date accounting)*** *Neni 7, pika 8* Në këtë rresht paraqitet vlera e netuar midis *cash*-it të arkëtueshëm dhe *cash*-it të pagueshëm, ku të dyja, blerjet dhe shitjet e rregullta në pritje të shlyerjes, janë shlyer mbi bazën e "dorëzimit kundrejt pagesës" *(DVP)* në përputhje me nenin 7, pika 8, të rregullores.
0140	**Blerjet e rregullta në pritje të shlyerjes: Njohja e plotë e detyrimeve për t'u paguar në rastet e kontabilizimit, sipas datës së shlyerjes (*settlement date accounting)*** *Neni 7, pika 9* Në këtë rresht paraqitet vlera nominale e plotë e angazhimeve për t'u paguar në lidhje me blerjet e rregullta, për bankat që, në përputhje me standardet kontabël në fuqi, zbatojnë kontabilizimin sipas datës së shlyerjes *(settlement date accounting)* për blerjet dhe shitjet e rregullta. Titujt e lidhur me shitjet e rregullta raportohen në rreshtin {0160} "Aktive të tjera".
0150	**(-) Blerjet e rregullta në pritje të shlyerjes: netimi i detyrimeve për t'u paguar në rastet e kontabilizimit sipas datës së shlyerjes (*settlement date accounting)***

	Neni 7, pika 9 Në këtë rresht paraqitet pjesa e vlerës së raportuar në rreshtin 0140, e netuar me vlerën e plotë nominale të *cash*-it të arkëtueshëm për shitjet e rregullta në pritje të shlyerjes, në përputhje me nenin 7, pika 9.
0160	**Aktive të tjera** *Neni 6, pika 3, shkronja "a"* Në këtë rresht paraqitet vlera e të gjitha aktiveve, përveç kontratave derivative, të parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, derivativëve të kredisë dhe transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve. Bankat e bazojnë vlerësimin në parimet e përcaktuara në nenin 6, pika 4, të rregullores. Bankat përfshijnë në këtë rresht *cash*-in e arkëtueshëm ose çdo titull të dhënë kundërpartisë nëpërmjet transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve dhe që mbahet në bilanc (d.m.th. që nuk janë plotësuar kriteret kontabël për mosnjohjen). Bankat përfshijnë në këtë rresht edhe zërat që janë zbritur nga zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë (p.sh. aktivet e patrupëzuara, aktivet tatimore të shtyra etj.). Vlera e raportuar në rreshtin {0170} nuk merret parasysh si reduktim në llogaritjen e këtij rreshti. Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it raportohen në rreshtat {0180} deri në {0230} dhe jo në këtë rresht.
0170	**(-) Rregullimet *(adjustments)* e përgjithshme të rrezikut të kredisë për zërat e bilancit** *Neni 7* Në këtë rresht paraqitet shuma e zbritjeve që u korrespondon zërave të aktiveve të bilancit të referuara në nenin 6, pika 3, shkronja "a", të cilat bankat i zbresin në përputhje me pikën 2 të nenit 7 të rregullores. Shuma e raportuar nuk do të konsiderohet si reduktim në llogaritjen e vlerës së aktiveve të tjera të raportuara në rreshtin {0160}.
0180	**Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që nuk mund të netohen nga pikëpamja prudenciale: vlera sipas standardeve kontabël** *Neni 7, pika 6* Në këtë rresht paraqitet vlera kontabël e marrëveshjeve të grumbullimit të *cash*-it, ku balancat kreditore ose debitore të disa llogarive individuale kombinohen për qëllime të administrimit të *cash*-it ose të likuiditetit, të cilat nuk mund të netohen në përputhje me pikat 4 dhe 5 të nenit 7.
0190	**Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që nuk mund të netohen nga pikëpamja prudenciale: ndikimi i shtesave të vlerës *(grossing-up)* të netimit të aplikuar sipas standardeve kontabël** *Neni 7, pika 6* Në këtë rresht paraqitet vlera e netuar sipas standardeve kontabël në fuqi për marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që nuk mund të netohet nga pikëpamja prudenciale, e raportuar në rreshtin {0180}.
0200	**Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që mund të netohen nga pikëpamja prudenciale: vlera sipas standardeve kontabël** *Neni 7, pikat 4 dhe 5*

	Në këtë rresht paraqitet vlera kontabël e marrëveshjeve të grumbullimit të *cash*-it, ku balancat kreditore ose debitore të disa llogarive individuale kombinohen për qëllime të administrimit të *cash*-it ose të likuiditetit, të cilat mund të netohen në përputhje me pikat 4 dhe 5 të nenit 7.
0210	**Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që mund të netohen nga pikëpamja prudenciale: ndikimi i shtesave të vlerës *(grossing-up*) të netimit të aplikuar sipas standardeve kontabël** *Neni 7, pika 4* Në këtë rresht paraqitet vlera e netuar sipas standardeve kontabël në fuqi për marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që mund të netohet nga pikëpamja prudenciale, e raportuar në rreshtin {0200}. Kur bankat kryejnë transferimin mbi baza ditore të balancave debitore dhe kreditore në një llogari të vetme, ato nuk aplikojnë shtesat e vlerës *(gross-up)* në këtë rresht, mbi balancat e llogarive individuale të klientëve të cilave iu vendoset vlera zero gjatë procesit të transferimit të parashikuar në pikën 4 të nenit 7.
0220	**(-) Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që mund të netohen nga pikëpamja prudenciale: Njohja e netimit në përputhje me nenin 7, pika 4** *Neni 7, pika 4* Në këtë rresht paraqitet vlera e netuar nga ekspozimi bruto i lidhur me marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it (shuma e rreshtave {0200} dhe {0210}), në përputhje me nenin 7, pika 4.
0230	**(-) Marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it që mund të netohen nga pikëpamja prudenciale: Njohja e netimit në përputhje me nenin 7, pika 5** *Neni 7, pika 5* Në këtë rresht paraqitet vlera e netuar nga ekspozimi bruto i lidhur me marrëveshjet e grumbullimit të *cash*-it (shuma e rreshtave {0200} dhe {0210}), në përputhje me nenin 7, pika 5.
0240	**Shtesa e vlerës *(gross-up)* për kolateralin e dhënë për derivativët** *Neni 8, pika 9* Në këtë rresht paraqitet vlera e çdo kolaterali të dhënë për derivativët, ku dhënia e këtij kolaterali redukton vlerën e aktiveve, sipas standardeve kontabël në fuqi, siç përcaktohet në nenin 8, pika 9.
0250	**(-) Aktivet e marra në kujdestari *(fiduciary assets)*** *Neni 7, pika 3* Në këtë rresht paraqitet vlera e aktiveve të marra në kujdestari, të njohura në bilancin e bankës në përputhje me standardet kontabël, të cilat plotësojnë kriteret e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (përkatësisht SNRF9 për mosnjohjen (*derecogntion*) dhe, aty ku është e zbatueshme SNRF10 për moskonsolidimin (*deconsolidation*), në përputhje me nenin 7, pika 3, të rregullores, duke supozuar se nuk ka netim kontabël apo efekte të tjera të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë (d.m.th. çdo efekt i netimit kontabël ose teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë që ndikon në vlerën kontabël, duhet të stornohet). Vlera e raportuar është përfshirë gjithashtu edhe në zërin "Aktive të tjera", të raportuara në rreshtin {0160}.
0260	**(-) Ekspozimet e titullzuara të përjashtuara që përfaqësojnë transferimin e një pjese të konsiderueshme të rrezikut** *Neni 6, pika 6* Në këtë rresht paraqiten ekspozimet e titullzuara nëpërmjet titullzimit tradicional që plotësojnë kushtet

	për transferimin e një pjese të konsiderueshme të rrezikut, të parashikuara në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit. Shuma e raportuar përfshihet edhe në rreshtat përkatës më sipër, në rastet kur nuk zbatohet asnjë përjashtim.
0270	**(-) Rezervat e përjashtuara në bankën qendrore** *Neni 6, pikat 8 dhe 9* Shuma e raportuar në këtë rresht përfshihet edhe në rreshtat përkatës më sipër, në rastet kur nuk zbatohet asnjë përjashtim.
0280	**(-) Vlera e aktiveve që zbritet nga kapitali i nivelit të parë** *Neni 6, pika 5* Në këtë rresht përfshihen të gjitha zbritjet/rregullimet në vlerën e një aktivi, në përputhje me: nenet 7–10; ose nenet 11–19; ose nenet 25–29 të rregullores së kapitalit rregullator, sipas rastit. Bankat marrin parasysh edhe trajtimin sipas nenit 20 të rregullores së kapitalit rregullator. Për të shmangur llogaritjen e dyfishtë, bankat nuk raportojnë në këtë rresht, rregullimet e aplikuara njëherë në zbatim të nenit 7, pika 2, të rregullores, kur llogarisin vlerën e ekspozimit në rreshtin {0010} deri në rreshtin {0270}, si dhe nuk raportojnë rregullimet që nuk zbriten nga një zë aktivi. Meqenëse këto vlera janë zbritur njëherë nga vlera e kapitalit të nivelit të parë, ato do të zvogëlojnë edhe ekspozimin total dhe raportohen si një vlerë negative në këtë rresht.
0290	**Vlera totale e ekspozimit për qëllime të llogaritjes së raportit të levës financiare** Në këtë rresht bankat raportojnë shumën e të gjithë rreshtave nga {0010} deri në {0280}.
Rreshti	**Kapitali**
0300	**Kapitali i nivelit të parë** *Neni 6, pika 2* Në këtë rresht raportohet vlera e kapitalit të nivelit të parë, e llogaritur në përputhje me rregulloren e kapitalit rregullator.
Rreshti	**Raporti i levës financiare**
0310	**Raporti i LEVËS FINANCIARE** *Neni 6, pika 1* Në këtë rresht paraqitet raporti i levës financiare i llogaritur sipas nenit 6, pika 1, të rregullores.

II. Formulari F2 – Trajtimi alternativ i vlerës së ekspozimit

1. Ky formular raportimi siguron të dhëna për një trajtim alternativ të vlerës së ekspozimit të derivativëve, transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve dhe zërave jashtë bilancit.

2. Bankat përcaktojnë "Vlerën kontabël në bilanc" në formularin F2, bazuar në standardet kontabël të zbatueshme. Terminologjia "Vlera kontabël duke supozuar që nuk ka netim ose teknika të tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë" i referohet vlerës kontabël në bilanc, duke mos marrë parasysh efektet e netimit ose teknikave të tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë.

3. Bankat raportojnë zërat e formularit F2, sikur zërat me shenjë negative në formularin F1 (për shembull përjashtimet/zbritjet), në përputhje me konvencionet e shenjave të parashikuar në seksionin 1.3 të këtij aneksi, përveç rreshtit {0280}, të mos merreshin në konsideratë.

{Rreshti dhe kolona}	**Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin**
{0010;0010}	**Derivativët - Vlera kontabël në bilanc** Kjo qelizë është shuma e qelizave {0020;0010}, {0050;0010} dhe {0060;0010}.
{0010;0020}	**Derivativët - Vlera kontabël, duke supozuar që nuk ka netim ose teknika të tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë** Kjo qelizë është shuma e qelizave {0020;0020}, {0050;0020} dhe {0060;0020}.
{0010;0030}	**Derivativët - Shuma nominale (*notional*)** Kjo qelizë është shuma e qelizave {0020;0030}, {0050;0030} dhe {0060;0030}.
{0020;0010}	**Derivativët e shitur të kredisë - Vlera kontabël në bilanc** Vlera kontabël në bilanc e derivativëve të kredisë, sipas standardeve kontabël në fuqi, ku banka shet mbrojtje kredie ndaj një kundërpartie dhe kontrata njihet si një aktiv në bilanc.
{0020;0020}	**Derivativët e shitur të kredisë - Vlera kontabël, duke supozuar që nuk ka netim ose teknika të tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë** Vlera kontabël në bilanc e derivativëve të kredisë, sipas standardeve kontabël në fuqi, ku banka shet mbrojtje kredie ndaj një kundërpartie dhe kontrata njihet si një aktiv në bilanc, duke supozuar se nuk ka netim për qëllime prudenciale ose kontabël apo efekte të tjera të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë (d.m.th., çdo efekt i netimit kontabël ose teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë që ka ndikuar në vlerën kontabël, do të stornohet).
{0020;0030}	**Derivativët e shitur të kredisë - Shuma nominale (*notional*)** Kjo është shuma e qelizave {0030;0030} dhe {0040;0030}.
{0020;0040}	**Derivativët e shitur të kredisë - Shuma nominale (*notional*) efektive** Banka paraqet shumën nominale (*notional*) të referuar nga derivativët e shitur të kredisë, si në qelizën {0020;0030}, pas zbritjes së diferencave negative në vlerën e drejtë që janë përfshirë në kapitalin e nivelit të parë, në lidhje me këta derivativë të shitur të kredisë.
{0030;0030}	**Derivativët e shitur të kredisë, të cilët janë subjekt i një klauzole të përfundimit (*close-out*) - Shuma nominale (*notional*)** Banka paraqet shumën nominale (*notional*) të referuar nga derivativët e kredisë, ku banka shet mbrojtje kredie ndaj një kundërpartie, subjekt i një klauzole të përfundimit (*close-out*). Një klauzolë e përfundimit (*close-out*) është një klauzolë që i jep palës që nuk ka dështuar, të drejtën për të përfunduar dhe mbyllur në kohë të gjitha transaksionet në bazë të marrëveshjes midis palëve, në rastet e dështimit të kundërpartisë, duke përfshirë edhe paaftësinë paguese ose falimentimin e kësaj të fundit. Bankat do të marrin në konsideratë të gjithë derivativët e kredisë, jo vetëm ata të mbajtur në librin e tregtueshëm.

{0040;0030}	**Derivativët e shitur të kredisë, të cilët nuk janë subjekt i një klauzole të përfundimit (*close-out*) - Shuma nominale (*notional*)** Banka paraqet shumën nominale (*notional*) të referuar nga derivativët e kredisë, ku banka shet mbrojtje kredie ndaj një kundërpartie, që nuk janë subjekt i një klauzole të përfundimit (*close-out*). Një klauzolë e përfundimit (*close-out*) është një klauzolë që i jep palës që nuk ka dështuar të drejtën për të përfunduar dhe mbyllur në kohë të gjitha transaksionet në bazë të marrëveshjes midis palëve, në rastet e dështimit të kundërpartisë, duke përfshirë edhe paaftësinë paguese ose falimentimin e kësaj të fundit. Bankat do të marrin në konsideratë të gjithë derivativët e kredisë, jo vetëm ata të mbajtur në librin e tregtueshëm.
{0050;0010}	**Derivativët e blerë të kredisë - Vlera kontabël në bilanc** Vlera kontabël në bilanc e derivativëve të kredisë, sipas standardeve kontabël në fuqi, ku banka blen mbrojtje kredie nga një kundërparti dhe kontrata njihet si një aktiv në bilanc. Bankat do të marrin në konsideratë të gjithë derivativët e kredisë, jo vetëm ata të mbajtur në librin e tregtueshëm.
{0050;0020}	**Derivativët e blerë të kredisë - Vlera kontabël duke supozuar që nuk ka netim ose teknika të tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë** Vlera kontabël në bilanc e derivativëve të kredisë, sipas standardeve kontabël në fuqi, ku banka blen mbrojtje kredie nga një kundërparti dhe kontrata njihet si një aktiv në bilanc, duke supozuar se nuk ka netim për qëllime prudenciale ose kontabël apo efekte të tjera të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë (d.m.th., çdo efekt i netimit kontabël ose teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë që ka ndikuar në vlerën kontabël, do të stornohet). Bankat do të marrin në konsideratë të gjithë derivativët e kredisë, jo vetëm ata të mbajtur në librin e tregtueshëm.
{0050;0030}	**Derivativët e blerë të kredisë - Shuma nominale (*notional*)** Banka paraqet shumën nominale (*notional*) të referuar nga derivativët e kredisë, ku banka blen mbrojtje kredie nga një kundërparti. Bankat do të marrin në konsideratë të gjithë derivativët e kredisë, jo vetëm ata të mbajtur në librin e tregtueshëm.
{0050;0040}	**Derivativët e blerë të kredisë - Shuma nominale (*notional*) efektive** Banka paraqet shumën nominale (*notional*) të referuar nga derivativët e blerë të kredisë, si në qelizën {0050;0030}, pas zbritjes së diferencave pozitive në vlerën e drejtë, që janë përfshirë në kapitalin e nivelit të parë, në lidhje me këta derivativë të blerë të kredisë.
{0050;0050}	**Derivativët e blerë të kredisë - Shuma nominale (*notional*) efektive (i njëjti emër referencë)** Shuma nominale (*notional*) e referuar nga derivativët e kredisë, ku banka blen mbrojtje kredie në të njëjtin emër referencë si ata derivativë kredie të shitur nga banka raportuese. Për qëllime të raportimit të vlerës së kësaj qelize, emrat referencë konsiderohen të njëjtë nëse i referohen të njëjtit personi juridik dhe niveli përparësie (senioriteti). Mbrojtja e kredisë e blerë në një grup të subjekteve referuese konsiderohet e njëjtë, nëse kjo mbrojtje është ekuivalente me blerjen e mbrojtjes në mënyrë të veçuar, për secilin prej emrave individualë në grupin përkatës.

	Nëse banka blen mbrojtje kredie në një grup emrash referencë, atëherë kjo mbrojtje do të konsiderohet e njëjtë, vetëm nëse mbrojtja e blerë e kredisë mbulon tërësinë e nëngrupeve të grupit mbi të cilin është shitur mbrojtja e kredisë. Në këtë mënyrë, netimi mund të njihet vetëm kur grupi i subjekteve referencë dhe niveli i varësisë në të dy transaksionet janë identikë. Për secilin emër referencë, shumat nominale (*notional*) të mbrojtjes së blerë të kredisë që paraqiten në këtë qelizë nuk duhet të tejkalojnë shumat e raportuara në qelizat {0020;0040} dhe {0050;0040}.
{0060;0010}	**Derivativët financiarë - Vlera kontabël në bilanc** Vlera kontabël në bilanc, sipas standardeve kontabël në fuqi, e kontratave të listuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, ku kontrata njihet si një aktiv në bilanc.
{0060;0020}	**Derivativët financiarë - Vlera kontabël, duke supozuar që nuk ka netim ose teknika të tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë** Vlera kontabël në bilanc, sipas standardeve kontabël në fuqi, e kontratave të listuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, ku kontrata njihet si një aktiv në bilanc, duke supozuar se nuk ka netim për qëllime prudenciale ose kontabël apo efekte të tjera të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë (d.m.th., çdo efekt i netimit kontabël ose teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë që ka ndikuar në vlerën kontabël, do të stornohet).
{0060;0030}	**Derivativët financiarë - Shuma nominale (*notional*)** Banka paraqet në këtë qelizë shumën nominale (*notional*) të referuar nga kontratat e përcaktuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.
{0070;0010}	**Transaksionet e financimit nëpërmjet titujve - Vlera kontabël në bilanc** Vlera kontabël në bilanc e transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve, sipas standardeve kontabël në fuqi, ku kontratat njihen si aktive në bilanc. Bankat nuk përfshijnë në këtë qelizë *cash*-in e marrë ose ndonjë titull që i është dhënë një kundërpartie nëpërmjet këtyre transaksioneve dhe mbahet në bilanc (d.m.th., nuk janë plotësuar kriteret kontabël për mosnjohjen). Në këtë rast, bankat përfshijnë këtë vlerë në qelizën {0080,0010}.
{0070;0020}	**Transaksionet e financimit nëpërmjet titujve - Vlera kontabël, duke supozuar që nuk ka netim ose teknika të tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë** Vlera kontabël në bilanc, sipas standardeve kontabël në fuqi, ku kontratat njihen si aktive në bilanc, duke supozuar se nuk ka netim për qëllime prudenciale ose kontabël apo efekte të tjera të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë (d.m.th., çdo efekt i netimit kontabël ose teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë që ka ndikuar në vlerën kontabël, do të stornohet). Bankat nuk përfshijnë në këtë qelizë *cash*-in e marrë ose ndonjë titull që i është dhënë një kundërpartie nëpërmjet këtyre transaksioneve dhe mbahet në bilanc (nuk janë plotësuar kriteret kontabël për mosnjohjen). Në këtë rast, bankat përfshijnë këtë vlerë në qelizën {0080,0020}.
{0080;0010}	**Aktivet e tjera - Vlera kontabël në bilanc** Vlera kontabël në bilanc, sipas standardeve kontabël në fuqi, e të gjitha aktiveve, përveç kontratave të përcaktuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, derivativëve të kredisë dhe transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve.
{0080;0020}	**Aktivet e tjera - Vlera kontabël, duke supozuar që nuk ka netim ose teknika të tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë** Vlera kontabël në bilanc, sipas standardeve kontabël në fuqi, e të gjitha aktiveve, përveç kontratave të përcaktuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, derivativëve të kredisë dhe transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve, duke supozuar që nuk ka netim kontabël apo efekte

	të tjera të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë (d.m.th., çdo efekt i netimit kontabël ose teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, që ka ndikuar në vlerën kontabël, do të stornohet).
{0090;0030}	**Zërat jashtë bilancit** Banka paraqet vlerën nominale të zërave jashtë bilancit. Bankat nuk përfshijnë në këtë qelizë kontratat e parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, derivativët e kredisë dhe transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, në përputhje me nenin 11, pika 1, të rregullores.
{0100;0020}	**Kolaterali në *cash* i marrë nga transaksionet e derivativëve - Vlera kontabël, duke supozuar që nuk ka netim ose teknika të tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë** Vlera kontabël në bilanc, sipas standardeve kontabël në fuqi, e garancisë/kolateralit në *cash* të marrë nga transaksionet e derivativëve, duke supozuar që nuk ka netim kontabël apo efekte të tjera të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë (d.m.th., çdo efekt i netimit kontabël ose i teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë që ka ndikuar në vlerën kontabël, do të stornohet). Për qëllime të kësaj qelize, *cash*-i vlerësohet si shuma totale e *cash*-it ku përfshihen monedhat dhe kartëmonedhat. Shuma totale e depozitave të mbajtura në bankat qendrore është e përfshirë në masën që këto depozita mund të tërhiqen në situata stresi. Në këtë qelizë, bankat nuk raportojnë depozitat/vendosjet pranë bankave të tjera.
{0110;0020}	**Shuma të arkëtueshme për kolateralin në *cash* të postuar në transaksionet e derivativëve – Vlera kontabël, duke supozuar që nuk ka netim ose teknika të tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë** Vlera kontabël në bilanc, sipas standardeve kontabël në fuqi, e shumave të arkëtueshme për kolateralin në *cash* të postuar në transaksionet e derivativëve, duke supozuar që nuk ka netim kontabël apo efekte të tjera të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë (d.m.th., çdo efekt i netimit kontabël ose teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë që ka ndikuar në vlerën kontabël, do të stornohet). Bankat, që sipas standardeve kontabël në fuqi, lejohen të netojnë shumat e arkëtueshme për kolateralin në *cash* të postuar kundrejt detyrimeve derivative përkatëse (vlera e drejtë negative) dhe që kanë zgjedhur për ta bërë këtë trajtim kontabël, do të stornojnë netimin dhe do të raportojnë te shumat e arkëtueshmet neto në *cash*.
{0120;0020}	**Titujt e marrë në një transaksion të financimit nëpërmjet titujve që njihen si aktive - Vlera kontabël, duke supozuar që nuk ka netim ose teknika të tjera të zbutjes së rrezikut të kredisë** Vlera kontabël në bilanc, sipas standardeve kontabël në fuqi, për titujt e marrë në një transaksion të financimit nëpërmjet titujve, që njihen si aktive sipas standardeve kontabël në fuqi, duke supozuar që nuk ka netim kontabël apo efekte të tjera të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë (d.m.th., çdo efekt i netimit kontabël ose teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, që ka ndikuar në vlerën kontabël, do të stornohet).
{0130;0010}	**Rezervat në bankën qendrore - Vlera kontabël në bilanc** Bankat raportojnë, në përputhje me standardet kontabël në fuqi, vlerën e rezervave në bankën qendrore. Bankat do t'i raportojnë këto rezerva pavarësisht nëse ato janë të përjashtuara nga vlera e ekspozimit total, siç parashikohet në nenin 6, pikat 8 dhe 9, të rregullores.
{0140;0060}	**Vlera e rezervave në bankën qendrore e përdorur për llogaritjen e raportit të modifikuar të levës financiare, të përcaktuar në nenin 6 të rregullores - Vlera e ekspozimit**

	Vlera totale e mesatares ditore të rezervave të bankës në bankën qendrore, e llogaritur gjatë periudhës së mbajtjes së rezervave, deri në datën e raportimit, të cilat mund të përjashtohen në përputhje me nenin 6, pikat 8 dhe 9, të rregullores.
{0150;0060}	**Vlera e ekspozimit që përdoret për llogaritjen e raportit të modifikuar të levës financiare të përcaktuar në nenin 6 të rregullores - Vlera e ekspozimit** Vlera e ekspozimit total të bankës, siç përcaktohet në nenin 6, pika 3, të rregullores, duke përfshirë edhe vlerën e rezervave të përjashtuara, në përputhje me nenin 6, pikat 8 dhe 9, në datën e raportimit.

III. Formulari F3 – Metoda alternative e paraqitjes së elementeve përbërëse të shumës së ekspozimit total

1. Bankat raportojnë vlerat e ekspozimit total në formularin F3, pas zbatimit të përjashtimeve dhe zbritjeve në formularin F1, d.m.th. zërave me shenjë negative, në përputhje me konvencionet e shenjave në seksionin 1.3 të këtij aneksi, përveç rreshtit {0280}.

2. Bankat raportojnë ekspozimet e ponderuara me rrezikun, pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë dhe efekteve të zëvendësimit. Bankat raportojnë vlerën e ekspozimit për qëllime të raportit të levës financiare, në përputhje me ekspozimin origjinal, d.m.th., pa marrë parasysh ndonjë teknikë zbutjeje ose efekt zëvendësimi të zbatueshëm për ekspozimet e ponderuara me rrezikun.

Rreshti dhe kolona	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
{0010;0010}	**Zërat jashtë bilancit - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare llogaritet si shumë e rreshtave {0070}, {0080}, {0090} dhe {0100} të formularit F1.
{0010;0020}	**Zërat jashtë bilancit - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e zërave jashtë bilancit - duke përjashtuar transaksionet e financimit nëpërmjet titujve dhe derivativët - sipas metodës standarde. Për ekspozimet sipas metodës standarde, bankat përcaktojnë shumën e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, në përputhje me kreun III të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.
{0020;0010}	**Prej të cilave: Financimi Tregtar - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e zërave jashtë bilancit, në lidhje me financimin tregtar. Për qëllime të raportimit në formularin F3, zërat jashtë bilancit të lidhur me financimin tregtar mund të jenë në formën e letrave të kredisë së importit dhe eksportit të emetuara dhe të konfirmuara, të cilat janë afatshkurtra dhe të vetëlikuidueshme, si dhe transaksione të ngjashme.
{0020;0020}	**Prej të cilave: Financimi tregtar - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e zërave jashtë bilancit - duke përjashtuar transaksionet e financimit nëpërmjet titujve dhe derivativët e lidhur me financimin tregtar. Për qëllime të raportimit në formularin F3, zërat jashtë bilancit të lidhur me financimin tregtar mund të jenë në formën e letrave të kredisë së importit dhe eksportit të emetuara dhe të konfirmuara, të cilat janë afatshkurtra dhe të vetëlikuidueshme, si dhe transaksione të ngjashme.
{0030;0010}	**Derivativët - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare** Vlera e ekspozimit e derivativëve, për raportin e levës financiare.
{0030;0020}	**Derivativët - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun**

	Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë së derivativëve, llogaritur sipas kërkesave të kreut III të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, përfshirë edhe zërat jashtë bilancit.
{0040;0010}	**Transaksionet e financimit nëpërmjet titujve - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve.
{0040;0020}	**Transaksionet e financimit nëpërmjet titujve - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë së transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve, llogaritur sipas kërkesave të kreut III të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, përfshirë edhe zërat jashtë bilancit.
{0050;0010}	**Shumat e ekspozimit që vijnë si rezultat i trajtimit shtesë për derivativët e kredisë - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare** Kjo qelizë është e barabartë me diferencën midis rreshtave {0050} dhe {0060} të formularit F1.
{0060;0010}	**Aktive të tjera që i përkasin librit të tregtueshëm - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e zërave të raportuara në rreshtin {0160} të formularit F1, duke përjashtuar zërat e librit të bankës.
{0060;0020}	**Aktive të tjera që i përkasin librit të tregtueshëm - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun** Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut, e llogaritur sipas kërkesave të kreut VII të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, e shumëzuar me 12.5.
{0070;0010}	**Obligacione të garantuara - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve në formën e obligacioneve të garantuara, siç parashikohen në nenin 26 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0070;0020}	**Obligacione të garantuara – Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve në formën e obligacioneve të garantuara, siç parashikohen në nenin 26 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0080,0010}	**Ekspozimet e trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Kjo është shuma e qelizave nga {0090,0010} deri në {0120,0010}. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0080;0020}	**Ekspozimet e trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Kjo është shuma e qelizave nga {0090,0020} deri në {0120,0020}.

	Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0090;0010}	**Qeveritë qendrore dhe bankat qendrore - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore, siç parashikohen në nenin 12 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0090;0020}	**Qeveritë qendrore dhe bankat qendrore - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore, siç parashikohen në nenin 12 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0100;0010}	**Qeveritë rajonale dhe autoritetet lokale, të trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve ndaj qeverive rajonale dhe autoriteteve lokale, të trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore, siç parashikohen në pikat 2, 3 dhe 5, të nenit 13 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0100;0020}	**Qeveritë rajonale dhe autoritetet lokale të trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve ndaj qeverive rajonale dhe autoriteteve lokale të trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore, siç parashikohen në pikat 2, 3 dhe 5, të nenit 13 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0110;0010}	**Bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare të trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore – Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatave ndërkombëtare, siç parashikohen në pikën 3 të nenit 15 dhe në nenin 16 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0110;0020}	**Bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare të trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatave ndërkombëtare, siç parashikohen në pikën 3 të nenit 15 dhe në nenin 16 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0120;0010}	**Njësitë e sektorit publik të trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve ndaj njësive të sektorit publik, siç parashikohen në pikën 5 të nenit 14 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

	Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0120;0020}	**Njësitë e sektorit publik të trajtuara si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve ndaj njësive të sektorit publik, siç parashikohen në pikën 5 të nenit 14 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0130;0010}	**Ekspozimet ndaj qeverive rajonale, bankave shumëpalëshe të zhvillimit, organizatave ndërkombëtare dhe njësive të sektorit publik, që nuk trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Kjo vlerë është shuma e qelizave nga {0140,0010} në {0160,0010}. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0130;0020}	**Ekspozimet ndaj qeverive rajonale, bankave shumëpalëshe të zhvillimit, organizatave ndërkombëtare dhe njësive të sektorit publik, që nuk trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore – Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Kjo vlerë është shuma e qelizave nga {0140,0020} në {0160,0020}. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0140;0010}	**Qeveritë rajonale dhe autoritetet lokale që nuk trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve ndaj qeverive rajonale dhe autoriteteve lokale që nuk trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore, siç parashikohen në pikat 1 dhe 4 të nenit 13 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0140;0020}	**Qeveritë rajonale dhe autoritetet lokale që nuk trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve ndaj qeverive rajonale dhe autoriteteve lokale që nuk trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore, siç parashikohen në pikat 1 dhe 4 të nenit 13 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0150;0010}	**Bankat shumëpalëshe të zhvillimit që nuk trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Vlera e ekspozimit të levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit, siç parashikohen në pikat 1 dhe 4 të nenit 15 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0150;0020}	**Bankat shumëpalëshe të zhvillimit që nuk trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit, siç parashikohen në pikat 1 dhe 4 të nenit 15 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

	Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0160;0010}	**Njësitë e sektorit publik që nuk trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Vlera e ekspozimit të levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve ndaj njësive të sektorit publik, siç parashikohen në pikat 1 deri në 4, dhe 6 deri në 7, të nenit 14 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0160;0020}	**Njësitë e sektorit publik që nuk trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve ndaj njësive të sektorit publik, siç parashikohen në pikat 1 deri në 4, dhe 6 deri në 7, të nenit 14 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0170;0010}	**Institucionet e mbikëqyrura - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve ndaj institucioneve të mbikëqyrura, siç parashikohen në nenet 17, 17/1 dhe 17/2, të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0170;0020}	**Institucionet e mbikëqyrura - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve ndaj institucioneve të mbikëqyrura, siç parashikohen në nenet 17, 17/1 dhe 17/2, të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0180;0010}	**Ekspozime të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme, siç parashikohet në nenin 21 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0180;0020}	**Ekspozime të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme, siç parashikohet në nenin 21 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0190;0010}	**Prej të cilave: Ekspozime të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve të siguruara plotësisht me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale, siç parashikohet në nenin 22 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

	Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0190;0020}	**Prej të cilave: Ekspozime të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve të siguruara plotësisht me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale, siç parashikohet në nenin 22 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0200;0010}	**Ekspozime me pakicë (*retail*) - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve me pakicë, siç parashikohen në pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 10 dhe në nenin 20 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0200;0020}	**Ekspozime me pakicë (*retail*) - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve me pakicë, siç parashikohen në pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 10 dhe në nenin 20 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0210;0010}	**Prej të cilave: Ekspozime me pakicë (*retail*) ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve me pakicë ndaj SME-ve, siç parashikohen në nenin 10 dhe në nenin 20 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Për qëllime të kësaj qelize, termi "ndërmarrje të vogla dhe të mesme" ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0210;0020}	**Prej të cilave: Ekspozime me pakicë (*retail*) ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve me pakicë ndaj SME-ve, siç parashikohen në nenin 10 dhe në nenin 20 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Për qëllime të kësaj qelize, termi "ndërmarrje të vogla dhe të mesme" ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0220;0010}	**Ekspozime ndaj shoqërive tregtare (korporatave) - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Kjo vlerë është shuma e qelizave {0230,0010} dhe {0240,0010}. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0220;0020}	**Ekspozime ndaj shoqërive tregtare (korporatave) - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Kjo vlerë është shuma e qelizave {0230,0020} dhe {0240,0020}.

	Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0230;0010}	**Ekspozime ndaj shoqërive tregtare (korporatave) financiare - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve ndaj shoqërive tregtare (korporatave) financiare, siç parashikohen në nenin 19 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Për qëllime të raportimit në formularin F3, korporatat financiare nënkuptojnë sipërmarrje të rregulluara/mbikëqyrura dhe të parregulluara/pambikëqyrura, të ndryshme nga ato të përcaktuara në qelizën {0170;0010}, aktiviteti kryesor i të cilave është blerja e pjesëmarrjeve, ose ushtrimi i një ose më shumë veprimtarive të përcaktuara në nenin 54 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ose një shoqëri sigurimi dhe shoqëri risigurimi, përveç institucioneve të mbikëqyrura të raportuara në qelizën {0170;0010}. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0230;0020}	**Ekspozime ndaj shoqërive tregtare (korporatave) financiare - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve ndaj korporatave financiare, siç parashikohen në nenin 19 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Për qëllime të raportimit në formularin F3, korporatat financiare nënkuptojnë sipërmarrje të rregulluara/mbikëqyrura dhe të parregulluara/pambikëqyrura, të ndryshme nga ato të përcaktuara në qelizën {0170;0010}, aktiviteti kryesor i të cilave është blerja e pjesëmarrjeve, ose ushtrimi i një ose më shumë veprimtarive të përcaktuara në nenin 54 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ose një shoqëri sigurimi dhe shoqëri risigurimi, përveç institucioneve të mbikëqyrura të raportuara në qelizën {0170;0010}. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0240;0010}	**Ekspozime ndaj shoqërive tregtare (korporatave) jofinanciare - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve ndaj korporatave jofinanciare, siç parashikohen në nenin 19 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Kjo vlerë është shuma e qelizave {0250;0010} dhe {0260;0010}. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0240;0020}	**Ekspozimet ndaj shoqërive tregtare (korporatave) jofinanciare - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve ndaj korporatave jofinanciare, siç parashikohen në nenin 19 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Kjo vlerë është shuma e qelizave {0250;0020} dhe {0260;0020}. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0250;0010}	**Ekspozime ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve ndaj shoqërive tregtare, në formën e SME-ve, që trajtohen, sipas parashikimeve të nenit 19 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

	Për qëllime të kësaj qelize, termi "ndërmarrje të vogla dhe të mesme" ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0250;0020}	**Ekspozime ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve ndaj shoqërive tregtare, në formën e SME-ve, që trajtohen sipas parashikimeve të nenit 19 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Për qëllime të kësaj qelize, termi "ndërmarrje të vogla dhe të mesme" ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0260;0010}	**Ekspozimet, përveç ekspozimeve ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve ndaj shoqërive tregtare, që trajtohen sipas parashikimeve të nenit 19 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe që nuk janë raportuar në qelizat e mësipërme. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0260;0020}	**Ekspozimet, përveç ekspozimeve ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve ndaj shoqërive tregtare, që trajtohen sipas parashikimeve të nenit 19 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe që nuk janë raportuar në qelizat e mësipërme. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0270;0010}	**Ekspozime me probleme - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve me probleme, siç parashikohen në nenin 24 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.
{0270;0020}	**Ekspozime me probleme - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve me probleme, siç parashikohen në nenin 24 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.
{0280;0010}	**Ekspozime të tjera - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve që trajtohen sipas parashikimeve të nenit 17/1, pika 3; nenit 19, pika 3; dhe të neneve 25, 27, 28 dhe 29 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë aktivet që zbriten nga kapitali rregullator (p.sh. aktivet e patrupëzuara), por që nuk mund të klasifikohen ndryshe këtu, edhe nëse një klasifikim i tillë nuk kërkohet për përcaktimin e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, në kolonën {0020}. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0280;0020}	**Ekspozime të tjera - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde**

	Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve që trajtohen sipas parashikimeve të nenit 17/1, pika 3; nenit 19, pika 3; dhe të neneve 25, 27, 28 dhe 29 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0290;0010}	**Prej të cilave: Ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi - Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, sipas metodës standarde** Vlera e ekspozimit për raportin e levës financiare, e ekspozimeve në pozicione të krijuara nga titullzimi, që trajtohen sipas parashikimeve të nenit 27 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.
{0290;0020}	**Prej të cilave: Ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi - Ekspozimet e ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde** Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, e ekspozimeve në pozicione të krijuara nga titullzimi, që trajtohen sipas parashikimeve të nenit 27 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat raportojnë këtë shumë pas zbritjes së vlerës së ekspozimeve me probleme.

VENDIM
Nr. 64, datë 4.11.2020

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN "PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE – AIPS"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe të nenit 129, pika 6, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS", miratuar me vendimin nr. 36, datë 3.6.2020, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 19, pas pikës 8, shtohet pika 8/1, me përmbajtje si më poshtë:

"Nëse ka lidhur marrëveshje me një pjesëmarrës operator në sistemin AIPS, për mbajtjen e një fondi garancie si kërkesë e një autoriteti kompetent ndaj pjesëmarrësit operator, pjesëmarrësi shlyerës pranë të cilit do të mbahet fondi i garancisë, e administron këtë fond nëpërmjet një rezerve pranë llogarisë së tij të shlyerjes në sistemin AIPS. Për qëllime të administrimit dhe përdorimit të fondit të garancisë, pjesëmarrësi shlyerës autorizon pjesëmarrësin operator që të urdhërojë veprime të lëvizjes së fondeve nga kjo rezervë pranë llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit shlyerës në sistemin AIPS. Autorizimi jepet nëpërmjet formularit në shtojcën K, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga të dyja palët.".

b) Në nenin 20, në pikën 2, në fund të shkronjës "e" shtohen paragrafët vijues, me përmbajtje si më poshtë:

"Në këtë rast:

i. pjesëmarrësi operator njofton zyrtarisht Bankën e Shqipërisë mbi marrëveshjen e lidhur për këtë qëllim;

ii. nëse vendoset në marrëveshje se fondi i garancisë që do të mbahet pranë një subjekti që është pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në sistemin AIPS, do të administrohet nëpërmjet një rezerve pranë llogarisë së shlyerjes së atij pjesëmarrësi në sistemin AIPS në rolin e pjesëmarrësit shlyerës, atëherë pjesëmarrësi operator duhet të autorizohet prej pjesëmarrësit shlyerës që të urdhërojë veprime të lëvizjes së fondeve nga kjo

rezervë pranë llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit shlyerës në sistemin AIPS;

iii. autorizimi sipas pikës "ii" të mësipërme, jepet nëpërmjet formularit në shtojcën K, i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga të dyja palët;

iv. çdo formular sipas shtojcës K, i plotësuar dhe i nënshkruar nga dyja palët që kanë lidhur marrëveshjen, dorëzohet pranë Bankës së Shqipërisë nga pjesëmarrësi operator;

v. pjesëmarrësi operator duhet të njoftojë zyrtarisht pa asnjë vonesë Bankën e Shqipërisë, në rast zgjidhjeje ose çdo ndryshimi në marrëveshjen me palën për qëllime të administrimit dhe përdorimit të fondit të garancisë, e për rrjedhojë për çdo ndryshim në autorizimet përkatëse, në lidhje me shlyerjen në sistemin AIPS, duke njoftuar ndryshimet në marrëveshje, si dhe plotësuar dhe dorëzuar një formular të ri sipas shtojcës K, për çdo fshirje apo modifikim në lidhje me autorizimin për mbajtjen dhe përdorimin e rezervës për fond garancie.".

c) Neni 26 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

"1. Shlyerja e një instruksioni pagese kryhet menjëherë pasi ka marrë statusin "i hyrë" në sistemin AIPS.

2. Shlyerja e një instruksioni pagese konsiderohet përfundimtare për pjesëmarrësit urdhërues dhe përfitues që nga momenti i debitimit dhe i kreditimit të llogarive respektive të shlyerjeve.

3. Tërheqja e urdhërpagesës nuk mund të kryhet pas shlyerjes së saj, por mund të kthehet me kah të kundërt, iniciuar nga pala tjetër.".

d) Në nenin 37, pas pikës 4, shtohet pika 5, me përmbajtje si më poshtë:

"Për qëllime të lidhura me shlyerjen e sistemeve vartëse të operuara nga pjesëmarrës operatorë, nënkategoria "i", të cilët për arsye të detyrimit që buron nga kërkesa të autoritetit kompetent përkatës, vendosin për mbajtjen e një fondi garancie pranë një subjekti që është pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në sistemin AIPS, Banka e Shqipërisë mundëson krijimin e një rezerve për qëllim të administrimit dhe të përdorimit të fondit të garancisë, në kuadrin e shlyerjes në sistemin AIPS. Kjo rezervë administrohet në sistemin AIPS pranë llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit shlyerës në AIPS, me të cilin pjesëmarrësi operator ka një marrëveshje të posaçme për qëllime të administrimit të fondit të garancisë. Kur konsiderohet e nevojshme nga Banka e Shqipërisë, si dhe bazuar në kërkesa të autoritetit mbikëqyrës të sistemit vartës të operuar nga pjesëmarrësi operator, parametrat e kësaj rezerve konfigurohen në mënyrë që pjesëmarrësi, pranë llogarisë së shlyerjes së të cilit mbahet kjo rezervë, të mos kryejë debitime të saj, por kjo gjë t'i lejohet vetëm urdhrave të pjesëmarrësit operator përkatës.".

e) Në nenin 51, pika 1 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

"Një instruksion pagese konsiderohet që ka marrë statusin "i hyrë" në Sistemin AIPS kur të ketë kaluar të gjithë hapat e vlerësimit të vlefshmërisë së instruksionit, të filtrimit kundrejt listave të sanksioneve, e të rezultojë i vlefshëm për t'u shlyer, si dhe të ketë gjendje të mjaftueshme në llogaritë përkatëse të shlyerjes së pjesëmarrësve urdhërues për shlyerjen e tij. Në momentin që ka marrë statusin "i hyrë" në sistemin AIPS, instruksioni i pagesës konsiderohet i parevokueshëm.".

2. Pas shtojcës J, shtohet shtojca K, me titull: "Autorizim për mbajtjen dhe përdorimin e rezervës për fond garancie", bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Emisionit, Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, si dhe pjesëmarrësit e sistemit AIPS.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Luljeta Minxhozi

SHTOJCA K
AUTORIZIM PËR MBAJTJEN DHE PËRDORIMIN E REZERVËS PËR FOND GARANCIE

BANKA E SHQIPËRISË

SISTEMI AIPS
Autorizim për mbajtjen dhe përdorimin e rezervës për fond garancie për shlyerjen nga pjesëmarrësit operatorë

◉ **I Ri** ○ **Modifikim** ○ **Fshirje**

Qëllimi i aplikimit	☐Operim *live* ☐ Test dhe trajnim
Data e aplikimit	__.__.____
Data e aktivizimit	__.__.____

1. Pjesëmarrësi shlyerës	
BIC i pjesëmarrësit	
Emri i pjesëmarrësit	
2. Pjesëmarrësi operator	
BIC i sistemit vartës	
Emri i sistemit vartës	

Palët konfirmojnë se bien dakord si më poshtë:

1. *Pjesëmarrësi shlyerës 1 do të pasqyrojë në rezervën për fondin e garancisë pranë llogarisë së tij të shlyerjes çdo kreditim në favor të fondit të garancisë.*
2. *Pjesëmarrësi shlyerës 1 autorizon pjesëmarrësin operator 2 të urdhërojë në AIPS lëvizje të fondeve për të debituar rezervën e fondit të garancisë pranë llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit shlyerës, në favor të kreditimit të llogarive të shlyerjes së pjesëmarrësve në AIPS, që paraqiten dështues për instruksione shlyerjeje të sistemit vartës të operuar nga pjesëmarrësi operator.*
3. *Pjesëmarrësi shlyerës 1 autorizon pjesëmarrësin operator 2 të urdhërojë në AIPS lëvizje të fondeve për të debituar rezervën e fondit të garancisë pranë llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit shlyerës, në favor të kreditimit të llogarive të shlyerjes së pjesëmarrësve në AIPS, për të cilët pakësohen fondet e kontributit të tyre në fondin e garancisë, në kuadër të marrëveshjeve që kanë me pjesëmarrësin operator.*

Për pjesëmarrësin shlyerës	**Për pjesëmarrësin operator**
Autorizuesi	**Autorizuesi**
(Emri Mbiemri/nënshkrimi/vula)	***(Emri Mbiemri/nënshkrimi/vula)***

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 204
Datë: 2020/11/20 13:15:41
2efac90a-42f4-4e0b-bd2d-2fa7e3a5dfe4

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 208 lekë